

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Ernest Koliqi- Autori i kodeve tradicionale dhe fryma e tij moderne në  
letërsinë shqipe

MENTORJA:

Dr. Rovená Vata

KANDIDATI:

Arjan Dobraj

Gjakovë, 2018

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Ernest Koliqi- Autori i kodeve tradicionale dhe fryma e tij moderne në  
letërsinë shqipe

Komisioni:

Kryetar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

MENTORJA:

Dr. Rovena Vata

KANDIDATI:

Arjan Dobraj

Gjakovë, 2018

## **FALËNDERIME**

Ky punim diplome nuk është vetëm vepër personale e imja, por është fryt i kontributit dhe bashkëpunimit të disa personave që kam kënaqësinë t'i falenderoj në mënyrë të veçantë. Së pari do doja të shpreh mirënjohjen time për udheheqësen shkencore Dr. Rovenë Vata, e cila ishte një udheheqëse vizionare dhe shumë e përkushtuar në punë. E falenderoj nga zemra për sugjerimet e saj të vazhdueshme dhe për bashkëpunimin. Ky punim ka qenë një rrugë e gjatë dhe nuk do të kishte përfunduar me sukses pa inkurajimin dhe besimin e saj. Falënderimet e mia më të thella shkojnë për familjen time. Ua kushtoj këtë punim atyre, njerëzve që më kanë qëndruar pranë gjithmonë, që më japin përherë ngrohtësi, mbështetje, besim dhe në veçanti:

-Babait tim, i cili ka qenë gjithmonë shembulli im më i miri. Me dhimbjen e madhe që nuk nuk është afër meje më, i detyrohem për gjithçka në rrugëtimin tim të studimeve dhe të jetës!

-Nënës sime, personit që asnjëherë nuk e humb durimin dhe kujdesin karshi meje!

-Motrës sime, Arjetës, që e kam mbështetje për çdo detaj të ditës sime e që më bën të ndjehem krenar në çdo arritje të saj!

-Vëllezërve të mi, Fidanit dhe Albanit, që janë pjesë e pandarë e zemrës sime!

Faleminderit për lumturinë që më bëni të ndaj me ju çdo ditë!

## PASQYRA E LËNDËS

<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
1. Objekti dhe motivimi i temës .....	5
2. Metodologjia dhe metodat e punës .....	5
3. Baza teorike e punimit.....	6
4. Synimi i temës.....	6
<b>KREU I: Ndikimi i traditës shqiptare në krijimtarinë e Ernest Koliqit (“Hija e maleve”)</b> .....	<b>7</b>
1.1. Kodi tradicional në novelat “Gjaku” dhe “Miku” .....	7
1.2. Kodi i fantastikes në novelat “Kërcimtarja e Dukagjinit”, “Nusja e mrekullueshme”, “Zâna e fundme” .....	22
1.3. Elementet etnologjike dhe psikologjike në novelën “Se qofsh, pleqnofsh” .....	29
<b>KREU II: Koliqi përfaqësues i prozës moderne shqipe (“Tregtar flamujsh”)</b> .....	<b>35</b>
2.1. Simboli i flamurit si shenjë e identitetit kombëtar shqiptar .....	35
2.2. Roli i Hilush Vilzës dhe Gaspër Tragaçit.....	37
2.3. Tiparet e prozës poetike te Koliqi .....	38
<b>KREU III: Simboli universal i ujit i dhënë te Koliqi sipas trinitetit (“Pasqyrat e Narçizit”)</b> .....	<b>40</b>
3.1. Uji-zjarri-dheu .....	40
<b>PËRFUNDIME:</b> .....	<b>48</b>
<b>BIBLIOGRAFIA:</b> .....	<b>49</b>

# **HYRJE**

## **1. Objekti dhe motivimi i temës**

Ernest Koliqi shfaqet në letërsinë shqipe në një kohë kur ajo përjetonte zhvillime e prurje tejet interesante, kapërthime dhe ndërthurje tiparesh të rrymave e drejtimeve letrare tradicionale dhe evropiane, të afërta e të largëta mes tyre. Shfaqja e tij shënon pikën kulmore në zhvillimet letrare shqipe e njëkohësisht prurjen më origjinale e më të dallueshme brenda arealit të prozatorëve e poetëve të viteve '30-ta.

Koliqi skaliti me mjeshtëri të veçantë punën e tij prej shkrimtari. Ai bën pjesë në radhën e personaliteteve më të rëndësishme të letërsisë, arsimit, kulturës dhe historisë shqiptare. Krijimtaria e Koliqit është e gjithanshme. Filloi me poezi, pastaj vazhdoi me krijime në prozë, që e vunë në pah talentin e shkrimtarit shkodran. Ernest Koliqi është i njohur më shumë me shkrimet në prozë, duke u bërë themeluesi i prozës moderne shqipe në të gjitha aspektet tematike e stilistike.

Me të gjitha risitë në shtjellimin e temave të ndryshme, pastaj me përdorimin e temave tradicionale nga vendlindja e tij, me elemente fantastike, psikologjike, etnologjike, Ernest Koliqi shënon një kthesë të rëndësishme në letërsinë shqipe dhe qëndron në pedestalin më të lartë të kësaj letërsie. Punëtorit të palodhur të fushës së letërsisë e shkencës, i jep meritat në ndërtimin e komunikimit mes letërsisë shqipe dhe asaj botërore.

## **2. Metodologjia dhe metodat e punës**

Nga pikëpamja metodologjike, ky punim mbështetet mbi disa metoda bazë kërkimi. Metodologjia bazë për të realizuar këtë punim diplome është si rezultat i gërshetimit të disa metodave së bashku si metodën e krahasimit, metodën përshkruese, metodën biografike dhe metodën analizuese. Metoda e krahasimit është metoda që na lejon të bëjmë krahasimin e novelave dhe tregimeve të Ernest Koliqit, duke analizuar veçoritë e përbashkëta dhe dallimet mes tyre.

Kurse me anë të metodës përshkruese jepen detajet të tjera për psikologjinë e personazheve te veprat që kemi marrë për analizë. Pa dyshim, pjesë përbërëse e këtij punimi janë edhe shumë të dhëna biografike për jetën e Ernest Koliqit, të cilat i kemi vënë në pah përmes metodës biografike.

### **3. Baza teorike e punimit**

Studimet për veprën e Ernest Koliqit e duan një njohje të mirë dhe solide jo vetëm të çështjeve të brendshme të letërsisë, por edhe të faktorëve të jashtëm të saj, edhe të shkencave tjera që lidhen më të. Për realizimin e këtij studimi jemi bazuar në disa studime tjera për veprën e autorit, ne vetë veprat letare të tij, studime monografike, arkiva, intervista dhe shumë dokumente tjera. Kemi përdorur literaturë të pasur që kanë botuar studiuesit ndër vite, për jetën dhe veprën e Ernest Koliqit.

### **4. Synimi i temës**

Synimi i këtij studimi është nxjerrja në pah e sa më shumë elementeve psikologjike, etnografike, kulturore, tradicionale dhe fantastike të novelave dhe tregimeve të Ernest Koliqit. Gjithashtu një nga synimet kryesore të këtij studimi është të vë në pah dhe të analizojë tri simbole kryesore në veprat e këtij shkrimtari: ujin, dheun dhe zjarrin. Derisa elementet psikologjike, etnografike, kulturore, tradicionale dhe fantastike do të analizohen nga vëllimet me tregime e novela *“Tregtar flamujsh”* dhe *“Hija e maleve”*; elementet universale me karakter simbolik si uji, dheu dhe zjarri do të analizohen nga vëllimi me proza poetike *“Pasqyrat e Narç izit”*. Synimi kryesor i këtij punimi diplome është të paraqesë një tablo të plotë të profilit shumëdimensional të Ernest Koliqi si themeluesi i prozës moderne shqiptare.

# KREU I: Ndikimi i traditës shqiptare në krijimtarinë e Ernest Koliqit (“*Hija e maleve*”)

## 1.1. Kodi tradiocional në novelat “*Gjaku*” dhe “*Miku*”

Mendimi i Ernest Koliqit<sup>1</sup> se *letërsia asht pasqyra e shpirtit të një populli*, është mendimi i fuqishëm me domethënie letrare e historike që rrezaton edhe në kohën e sotme<sup>2</sup>. Këtë mendim e pasqyron edhe te veprat e tij.

Vepra letrare në prozë “*Hija e Maleve*” është një përmbledhje me dymbëdhjetë novela me autor Ernest Koliqin botuar më 1929 në Zarë. Novelat përbërëse të këtij vëllimi janë: “*Nusja e mrekullueshme*”, “*Gjaku*”, “*Kanga e re*”, “*Se qofsh, pleqnofsh*”, “*Kërcimtarja e Dukagjinit*”, “*Miku*”, “*Andërr e një mbasdite vere*”, “*Kur orët lajmrojnë*”, “*Kopshti*”, “*Ke tre lisat*”, “*Diloca*”, “*Zana e fundme*”.

Sipas kodit të zgjedhur, saktësia logjike e këtyre kundërvënieve mund të manifestohet në mënyrë të pabarabartë dhe të mos ngërthejë dallimet në natyrë. Vepra letrare, ku ky mit shfaqet, është “*para së gjithash vepër e ligjërimit*”<sup>3</sup>.

Te libri me tregime dhe novela, “*Hija e maleve*”, i cili përbëhet nga dymbëdhjetë tregime dhe novela, autori paraqet traditat dhe mentalitetin e njeriut shqiptar të zonës veriore, ku trajtohen probleme të shumta, të theksuara dhe të studiuara edhe nga studiuesit e veprës së Ernest Koliqit.

Kështu ndër temat dhe motivet që trajtohen në librin “*Hija e maleve*” janë edhe problem i fatit të intelektualit në shoqëri, në të cilin gërshetohen edhe motive të tjera që përvetësohen dhe pasurohen me elemente të tjera të shumta të një proze, e cila kap dimensionet e reales dhe të irrealës.

Po ashtu një vend të mirë zë edhe qenia mitologjike, e cila këtu del me një funksionalizim të qëndrueshëm; pastaj në tregimet e Koliqit hasim edhe motive të tjera siç është ai i besës, i mikpritjes, motivi i dashurisë i cili në tonalitetin kuptimësor zë një vend të veçantë dhe hapësirë të konsiderueshme në tërë prozën e Koliqit. Po ashtu në librin “*Hija e maleve*”

---

<sup>1</sup>Ernest Koliqi (Shkodër, 20 maj 1903 - Romë, 15 janar 1975) ishte mësues, poet, romancier, eseist, përkthyes, gazetar, dramaturg, ministër arsimit në qeverinë Vërlaci, botues dhe pedagog. Cilësohet bashkë me Mitrush Kutelin, si bashkëthemelues i tregimit modern shqiptar sa i përket krijimtarisë, ndërsa në punët politike e arsimore ka meritë për dërgimin e 200 arsimtarëve në Kosovë.

<sup>2</sup>Sali Bashota, *Domethënia e ideve letrare*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f. 198.

<sup>3</sup>Anton Berisha, *Ernest Koliqi, poet dhe prozator*, Toena, Tiranë, 1997, f. 65.

vërehet ndikimi i letërsisë popullore, me theks të veçantë ai i përrallës shqiptare, e cila në libër, natyrshëm, vjen e plotësuar dhe e përsosur<sup>4</sup>.

Dy aspektet më tipike të Kodit zakonor; besa e gjakmarrja, që njëkohësisht janë pjesë e rëndësishme e psikologjisë së shqiptarit, fokusohen në tregimin “*Miku*” dhe novelen “*Gjaku*”, siç e dëshmojnë vetë titujt<sup>5</sup>.

Te novela, ashtu siç tregon simbolikisht edhe vetë titulli, “*Gjaku*”, kemi të bëjmë me gjakun, bajrakun, kanunin e të themi mitin e palcës etnike shqiptare<sup>6</sup>.

Në përgjithësi në të gjitha këto novela Koliqi trajton tema që kanë në themel të tyre moralin e Malësisë dhe tragjizmin e jetës së saj me ndeshje me jetën dhe mentalitetin qytetar. Këtu jeta jepet në vazhdimsinë e saj dhe në vrullin e shndrrimeve.

Ernest Koliqi në studimet e veta letrare dhe estetike ka shprehur e mbrojtur pikëpamje të drejta dhe me interes shkencor aktual, teorik e praktik, edhe për frymën kombëtare (shqiptare) në letërsi e në kulturë si dhe për rolin e rëndësishëm që ajo luan në pasurimin dhe forcimin e vlerave letrare dhe të shpirtit kombëtar të një populli. Faktori etnik, mendon ai, luan një rol të madh në jetën e njeriut e të popullit të cilit ai i përket, lidhjet e tij lëndore e shpirtërore me token, ku ka lindur dhe me njerëzit e saj, janë lidhje të forta e të qëndrueshme, që nuk shlyhen lehtë<sup>7</sup>.

Toni i përgjithshëm i veprës është autentik-tragjik. Në novela nuk mungon as elementi i fantastikes. Koliqi gërsheton shumë mirë fantastiken dhe botën e pasur të mitologjisë shqiptare me realitetin bashkëkohor. Gjithashtu përmes novelave jepet jeta e shqiptarëve, mentaliteti i vendit, karakteret e ndryshme të njerëzve, shqetësimet dhe ambiciet e tyre, kamjet dhe skamjet e qyteteve.

“*Hija e maleve*” shtjellon jetën e shqiptarëve të paraqitur në dy këndvështrime: jeta e dikurshme me tradita e zakone dhe jeta e re me thyerjen e tabuve, ku bie ndesh tradicionalja me modernen.

Përmbledhja “*Hija e maleve*” cilësohet me natyrshmëri e vërtetësi të rrëfimit artistik. Në veprën e Koliqit trajton virtytet, që e kanë karakterizuar popullin gjatë shekujve, ato gjëra që e kanë mbajtur të fortë përballë ç do stuhie të jetës, të ndershëm, të pathyeshëm.

---

<sup>4</sup>Besim Muhadri, *Proza e Ernest Koliqit në kontekstin e letërsisë shqipe të shekullit XX*, në: “Albanologjia”, Vol. 4, Tetovë, Maqedoni, 2017, f. 152.

<sup>5</sup>Luara Smaqi, *Zbulimi i vetvetes n'pasqyrë t'letravet*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Departamenti i Studimeve Letrare, Tiranë, 2009, f. 45.

<sup>6</sup>Nysret Krasniqi, *Episteme letrare*, AIKD, Tiranë, 2010, f. 74.

<sup>7</sup>Hilushi, *Letra të hapuna një të riu letrar*, në: revistën “Shêjzat”, 1970, nr. 4-6, f. 99.



Ernest Koliqi dukshëm mbron traditën shqiptare kundrejt elemeteve të huaja dhe dëshira e tij ishte të rindërtohen vlerat, të përdoren, ndërsa për t'u eliminuar duhej veç dukuritë negative. Novela “Gjaku” është novela më komplekse në prozë e Koliqit. Nëpërmjet personazhit kryesorautori, ka shprehur pikëpamjet e tij për botën shqiptare; idetë për transformimin e kësaj bote dhe pengesat e pakalueshme për të realizuar këtë transformim.

Novela nis me pyetjen retorike ku personazhi Doda, protagonisti i novelës pyet se a ka ndonjë gjë më të mrekullueshme në këtë botë sesa t'i sjellësh qytetërimin një kombi që është zhytur në botën e padijes?!

*“A ka send më të mrekullueshëm në këtë botë se me i sjellë qytetërimin një kombi zhytë në errsinën e padijes?”<sup>8</sup>.*

Kështu fliste Doda tue bisedue me të dashtunën, nën një tândë hardhiash, në mes të një kopshti që mbrâmja mbulonte dalngadalë me fresk e me hije të kaltërta.

Këtë pyetje Doda ia shtron vetvetes dhe të dashurës së tij shkodrane, Nushës, e përmes saj edhe lexuesve të gjerë. Doda, një i ri i shkolluar larg vendlindjes, por i brumosur deri në palcë me mentalitetin shqiptar, dëshiron të bëhet një zë i fuqishëm i cili artikulon idenë e krijimit të një shoqërie përparimtare, e cila dukurinë e hakmarrjes do ta kujtonte vetëm si një relik të shëmtuar.

*“- A e zën besë që më përqethet shtati në një mënyrë të çuditshme kur shof në klasë para meje tridhetë kalamâj që, pa bâ zâ, rrijnë e ndëgjojnë fjalën teme? E shumta e tyne vijnë prej malve dhe janë djem krenësh e bajraktarësh. E kanë shpirtin virgjën. Më shkon mëndja, shpesh, te bora e pashkelun mbi të cilën ma e vogla gjurmë lën shêjin e vet. Thom me vete: “Kurrjâ s’dijnë: presin prej meje zhvillimin e sendeve më elementare të jetës”. E tue pá sytë e tyne të gjallë që hapen në mue, plot kureshtë, ku më duket se dalloj edhe kureshtjen e pashueme të etënve, gjyshave e stërgjyshave që nuk dijnë ç’âsht shkolla, më kapin të dridhunat. Âsht përgjegjësi e madhe, pasha Zotin. Apo jo?”<sup>9</sup>.*

Ai mendon se shoqëria ndryshon nëpërmjet mësimin dhe mësimi realizohet nëpërmjet librit, kulturës, dhe dijes. Prandaj nis të shkruajë librin e tij.

*“- Tashti e kupton vetë misionin e madhnueshëm që duhej të kryejë çdo shqiptar i kulturuem përgjithsisht e, në mënyrë të veçantë, një mësues si unë”<sup>10</sup>.*

---

<sup>8</sup> Ernest Koliqi, novela *Gjaku*, në: “Hija e maleve”, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 15.

<sup>9</sup>Po aty, f. 17-18.

<sup>10</sup>Ernest Koliqi, novela *Gjaku*, f. 16.

*Ai mendon se shoqëria duhet të transformohet duke u mbështetur në kulturën vendase, por duke shmangur cilësitë negative të sjelljes e të karakterit, si hakmarrjen. Pyetjet që Doden e shqetësojnë më shumë janë në lidhje me diturinë, dijën, qytetërimin. “Due me thanë: a është e arsyeshme t’u japim mësim si të ishin djem të Evropës? Është e para herë që gjaku i tyne, mbas qindra e qindra vjetësh, po vjen në përpjekje me kulturë. A ka me mujtë me u hy për palcë shpirti i kësaj kulture? A por njohtunitë e ndryshme kanë me i veshë me një lustër të sipërfaqshme, me një lëvore të ligësht që bien me të parën rasë? Ndoshta kështu rrisim një brezni të rijsh gjysmakë të cilëve kultura u shlyen ndiesitë e freskëta tue u lânë, në vënd të tyne, një ndërgjegje të ndriçuese për gjysmë, pezull ndër parime të pangulituna...”<sup>11</sup>.*

Këto vese ai i sheh më tepër si pasojë e rrethanave, sesa e botës shpirtërore malësore.

*“- Ai që kalon nëpër popull me hedhë farën për një jetë më të mirë, ai që e ndriçon me një dritë më të bukur tokën që na ushqen, ai që bân me ngadhnjye agimet në muzgun e pacaktuem të shpirtnave; shkurt: kush i difton popullit të udhë të re qytetnie të vërtetë, është i denjë me qënë i nderuen si gjysmë perëndie”<sup>12</sup>.*

Ndërkohë Doda dashuron vajzën shkodrane, Nushën, dhe ëndërron një jetë të qetë me të, në lumturi e në harmoni.

*“Por, në Shqipni, për me bâ diçka, nuk mjafton me krye vetëm detyrën. Vajza, tue qeshë, ia vûni gishtin diftues në ballë e tha me një kërcnim të âmbël: - Sa mëndime të zorshme ke aty mbrëndë...”<sup>13</sup>.*

Po rrjedha e jetës së tij ndryshon, kur ai merr lajmin se ia kanë vrarë të vëllanë, Zekën, në malësi. Atëherë ai kthehet në mjedisin shpirtëror të fëmijërisë së tij, ku ndeshet me dyshimin e babait se Doda s’është i zoti t’ia marrë gjakun vëllait, sipas Kanunit.

*“Plaku tundi kryet, mandej e coi përpjetë në shênj mohimi.*

*Tha:*

*Mirë, shko: udhambarë të kjoftë. Por.. një amanet due me ta lânë: në most ë pastë zburruue krejt shkolla, mos e le pa krye atë borxh që ke...”<sup>14</sup>.*

Vëllai i vdekur ia lëkund ndjenjat e mendimet. Doda ndërpret punën për librin, i kthehet pijes, i zbehet dashuria për Nushën, bëhet njeri dilemave.

---

<sup>11</sup>Ernest Koliqi, novela *Gjaku*, f. 18.

<sup>12</sup>Po aty, f. 15-16.

<sup>13</sup>Po aty, f. 16.

<sup>14</sup>Po aty, f. 28.

*“Unë e dij çka kishe me mëndue ti për mue, mor i shkreti Zekë.. Ti kishe me mëndue se unë s’hyj me ta marrë gjakun për mos me humbë Nushën, punën që kam e stimën që më rrethon. E këtë..ti kishe me e njëhë ligшти. Në vend tem, për mue, ti kishe bâ namin, e dij.... S’e lâ, për ligшти, Zekë, jo; as për Nushën, as për dhimbje të pozitës. Por.. S’due me pasë në ballë zhigun e kriminelave. Ty kjo punë kishte me të bâ me qeshë, e dij... por... me i pasë këndue ti librat që unë këndova, më pasë jetue ti ndër vënde ku unë jetova..Por, jo, ndoshta edhe atëherë ti, për mue, kishe qitë pushkë deri tash..”<sup>15</sup>.*

Ai gjendet ndërmjet dy forcave të mëdha: njëra është teoria intelektuale sipas të cilës njeriu nuk duhet të vritet, dhe tjetra është kodi kanunor, që e mëson se haku duhet të merret. E gjitha kjo i krijon atij një trazim të madh në shpirt.

*“Jo, Zekë, mos e kërko prej meje. Mâ mirë âsht me vra veten!*

*Qytetnimi...Lidhësa të forta që e sigurojnë anijen për breg, larg valvitjes së rreptë të një deti tëfurishëm.. Por vjen vala dhe e lëkundë anijen me tërbim përpris dhe lidhësa nisin me u ligështue...*

*Qartësia shpirtnore.. Rreze e farfurishme që dersh arë e shkëndia të ylberta mbi kafshë e sênde të jetës së përditshme, tue e bâ mâ tëâmbël.. Por ré të zeza dalin e ndêhen anë për anë e rrezja zên me u dridhë, me u zbe, me u shue..*

*Njashtu âsht Shqipnia”<sup>16</sup>.*

As historia e nënës së Nushës, që haku të merret nëpërmjet tjetërkujt, as klithjet e dashurisë së Nushës dhe as prifti nuk mund ta ndihmojnë atë për të zgjedhur këtë dilemë. Në qenien e tij ka ndodhur një ndryshim i thellë dhe kjo nuk varet më prej askujt. Kështu Doda e vret gjaksin e vëllait të tij në Shkodër, i dorëzohet pushtetit dhe ndjen një lehtësim në thellësi të shpirtit.

*“Gjashtë të krisme revoleje kumbuen. Nikë Feta u përplas për tokë tue qitë gjak gjithkah. Gjindja u shpërndanë.*

*Katër a pesë malësorë, të bajrakut të tij, u turrën kah Doda, e britën:*

*Të lumtë pushka; lëshoje diçka për tokë për të mos me të zânëgjaku..E ik se po të hapim na rrugë..*

*Doda nuk u vinte vesh. U drejtue kah Fusha e Qelës, tue shí pushkën në xhep.*

*Marku e kapi për krahi:*

*Ku po shkon? Hajde të ikim. Sot e ke kollaj, pse âsht kallablllek i madh...*

*Doda e liroi krahin prej tij e përgjegji gjakftohtë:*

<sup>15</sup>Ernest Koliqi, novela *Gjaku*, f. 37.

<sup>16</sup>Po aty, f. 38.

*S'due me ikë-*

*Një toger gjëndarmerie, me revole në dorë, po ngiste vrap kah vëndi i vrasjes.*

*Doda i doli para dhe i tha:*

*Unë kam qitë pushkë, zoti toger. Po i dorëzohem zotnisë sate.*

*Togeri ia nguli sytë dhe e shikoi me çudi të madhe. Kurrë, në karrierën e gjatë të tij, ushtrie nën qeveri të ndryshme që sunduen herë pas here në vend tonë, kurrë s'i kishte takur me ndeshë gjaksor që dorëzohej me vullnetin e vet, në atë mënyrë”<sup>17</sup>.*

Novela “Gjaku” është ndërtuar mbi bazën e kundërvënies së të menduarit dhe të jetuarit real. Novela vazhdon me këtë paragraf: “Gjasht të krisme revolje kumbuen, Nikë Feta u përplas për tokë tue qitë gjak gjithkah. Gjindja u shpërndanë. Katër a pesë Malsorë, të bajrakut të tij, u turrën kah Doda e britën: – Të lumtë pushka; lëshoje diçka në tokë për mos me të zënë gjaku... E ik se po të hapim na rrugë... Doda nuk e vënte vesh. U drejtua kah Fusha e Qelës, tue shtë pushkën në xhep. Marku e kapi për krahi: Ku po shkon? Hajde t'ikim. Sod e ke kollaj, pse â kallaballëk i madh [...] Doda e liroi krahin prej tij e përgjegji gjak-ftohtë: S'due me ikë!<sup>18</sup>.

Koliqi e ndiente dhe e njihte traditën shqiptare. Qoftë nga pozicioni i dijetarit, qoftë nga pozicioni i njeriut qëështë rritë në fyrmën e kësaj tradite mbi të cilën ka shartuar dijet moderne mbi jetën dhe letërsinë<sup>19</sup>.

*“Po atëherë, ame i lânë në trashamaninë e tyne a? Vetëm kultura i bân njerëz”.*

*“- Edhe ti, djalë malesh je. Asnji prej gjindve të tu, atje në Malësi, s'dinë me këndue e me shkruë. Ti je mâ i pari i fisit tând që kapë libra e pënë në dorë. Por... ke pak qytetas që mund të krahasohen me ty. Edhe ata kalamâj, pra, që po thue, mund të qytetnohen si ti. Ti je shembull i gjallë për ta e për kë dyshimesh”<sup>20</sup>.*

Shqiptarin e mbuloi terri i padijes, nata shpirtnore, ku mungullojnë bestytnitë, lakmitë mâ të pandërgjegjëshme, mënitë, pësimet, dasitë.

Të huejve i dukemi popull anakronik, banues i tokës ku nuk mbinë fara e qytetnisë. Por ma e keqe është se dyshimi mbi zotësin e përparimit tonë ka nisë të depërtojë në disa zemra shqiptare<sup>21</sup>.

<sup>17</sup>Ernest Koliqi, novela, *Gjaku*, f. 49.

<sup>18</sup>Po aty, f. 58.

<sup>19</sup>Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe oraliteti*, E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku, AIKD, Prishtinë, 2002, f. 49.

<sup>20</sup>Po aty, f. 18.

<sup>21</sup>Matish Shestani, *Ernest Koliqi në mendimin e bashkëkohësve dhe studjuesve*, Pegi, Tiranë, 2000, f. 33.

*“Kush e di? Ndoshta na që jemi ulë prej malesh e kemi bâ shkollën rregullisht, mâ parë në vënd e mandej përjashta, s’jemi krejt si tjerët. Diçka na mungon...ase kemi diçka mâ tepër...”<sup>22</sup>.*

Koliqi luan me folklorin e jo folklori me Koliqin. Ai ia ka dalë që ta fusë folklorin në lojën strukturale të rrëfimit pa u bërë vetë pre e folklorit<sup>23</sup>.

*“Mos mendo se unë jam kundra kulturës oksidentale: asnjifje; jam vetëm kundra disa parimeve të saj që na pranojmë pa kontroll e që, më duket, ligështojnë cilësitë origjinale të racës shqiptare. Unë jam i mëndimit që, ndër shkolla fillore nëmos, duhet të marrim parasysh prirjet e mira e të këqia që çdo kalamâ shqiptar ka trashiguar, bashkë me gjak, prej të parëve. Mbi to duhet të punojmë, tue u përprjekë me shrranjosë të këqiat e me drejtue përdorimin e të mirave kah një qëllim njerëzor”<sup>24</sup>.*

Thënë në stilin e Koliqit, në tregimet, novelat dhe rrëfejtat e tij, është rindërtuar jeta shqiptare në frymën shqiptare. Aty ndjehet shqiptarësia e shkruarit, e narratorit, e personazheve, e mendimeve dhe e ndjesive të tyre: madje edhe e të folurit dhe e të shikuarit, e të qeshurit dhe të vrejturit. Ndihet antropologia shqiptare, si kontekst dhe si tekst<sup>25</sup>.

*“- Shqiptari është dreq: s’e harron kurrë të fyemen!”<sup>26</sup>.*

*“Prirjen e gjakmarrjes duhet me e bâ të zhduket prej shpirtnavet të njomë, më sa që ato të besës, të burrnisë, të mikpritjes etj., lypet me i forcue tue i dhënë një drejtim të mbarë, sepse shpesh edhe këto cilësi të mira shqiptari i vën në shërbim të një qëllimi të mbrapshtë”<sup>27</sup>.*

Raporti i kodit zakonor me atë civil jepet në raportin e hapësirës ku zhvillohen ngjarjet, raporti mes fshatit dhe qytetit<sup>28</sup>.

*“Tue ndjekë zakonin që ka dalë e ka zënë vënd tash vonë në Shkodër, Doba, mbas fejesës, vinte për gjithë të dielë mbasdite me ndejë te e fejuemja. Mbrapa, tue u njoftë mâ mirë e tue u*

---

<sup>22</sup>Matish Shestani, *Ernest Koliqi në mendimin e bashkëkohësve dhe studjuesve*, Pegi, Tiranë, 2000, f. 19.

<sup>23</sup>Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe oraliteti, E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku*, AIKD, Prishtinë, 2002, f. 42.

<sup>24</sup>Po aty, f. 19.

<sup>25</sup>Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe oraliteti, E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku*, AIKD, Prishtinë, 2002, f.55.

<sup>26</sup>Po aty, f. 20.

<sup>27</sup>Ernest Koliqi, novela, *Gjaku*, f. 21.

<sup>28</sup>Rovena Vata, *Miti i malit në letërsinë shqipe: Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Migjeni, Martin Camaj*, Naimi, Tiranë, 2013, f. 141.

*miqësue mâ tepër, filloi të duket tri a katër herë në javë, deri që, disa punë, të rrjedhuna në atë ndërkohë, ia çelën shtegun me hy e me dalë lirisht si në shtëpinë e vet*<sup>29</sup>.

Kryeheroi i quajtur Dodë, i ka vënë vetes për qëllim misonin e njeriut që në gjirin e njerëzve të tij do të përhapë qytetnim<sup>30</sup>.

*“Ai, djalë malësorësh, që një fat i veçantë e kishte shpëtue nga jeta e pagdhendun e maleve, e ndjente veten plotësisht të lumë afër asaj vajze shkodrane, në atë shtëpi të pastër e të qetë. Gjaku i tij, - gjaku i trashguem prej etënvjet luftarë që s’kishte gëzue kurrë një ças paqe, gjatë qindvjetëve të turbullta, - kishte etje butësie, nevojë pushimi. I dukej se gjindej, tashma, jashta rrymës së mëndershme që pëelan jetën e malësorëve ndër gjaqe, ndër kryengritje, ndër luftime bajrak me bajrak; e njehte veten të mbrojtun në atë oaz të njomë e të ndritshëm dashunie*<sup>31</sup>.

*“Në fund të shpirtit, një zâ i mësheftë i thonte se edhe të parët e patetësueshëm do të ishin të kënaqun për âmbëlsi që ai shijonte e që ata nuk njohtën*<sup>32</sup>”.

Doda “vetëvritet”, jo në favor tëçlirimit nga trauma e lindur në atmosferën dhe erën e gjakut që vjen nga bota ku ai qarkullon. Dua të them që, kur Doda vret, nuk fiton vetëm ideja e individit, e heroit intelektual<sup>33</sup>.

*“Gjâma e burrave, vaji i grave, vorrimi, dreka, i nxorën prej syshë lot të panjehun. Tash që kishte kthye në Shkodër, kokërr loti s’i kish teprue*<sup>34</sup>.

Rasti tipik është personazhi i Dodës të cilin e bëri vrasës hija e rëndë që mali lëshonte, hija e kodit zakonor, e bëri vrasës ekzistenca e këtij kodi. Ai duke qenë nën efektin e këtij kodi, vetëdija e tij ishte që ai të përfundonte me duar të gjakosura, sado e fortë që mund të jetë dija, zhvillimi perëndimor, malësorin e ndjek në nënvetëdije hija e malit, hija e kodit zakonor pasi nuk donte të ishte as djalë i lig e as tutës<sup>35</sup>, në sytë e rrethit dhe të Bajrakut. Doda gjendet mes

---

<sup>29</sup>Rovena Vata, *Miti i malit në letërsinë shqipe: Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Migjeni, Martin Camaj*, Naimi, Tiranë, 2013, f. 22.

<sup>30</sup>Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe oraliteti*, E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku, AIKD, Prishtinë, 2002, f.110.

<sup>31</sup>Po aty, f. 24.

<sup>32</sup>Po aty, f. 24.

<sup>33</sup>Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe oraliteti*, E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku, AIKD, Prishtinë, 2002, f.111.

<sup>34</sup>Po aty, f. 26.

<sup>35</sup>Sabri Hamiti, *Gjaku e Bajraku*, në: “Jeta e re”, nr. 1, Prishtinë, 1995, f. 105.

kodit civil që kishte lënë gjurmë në shkollimin e tij dhe kodit zakonor që e kishte rrënjësuar në vetëdijen e tij psikologjike, kjo vetëdije e bën Dodën qetë marr gjakun.

*“Zeka i vdekun, shtrë në mes të odës, me çakçirë të rij, ballin lidhë me një shami të kuqe që ia mbulonte birën e plumbit, rrypin e fishekëve të ngjeshun dhe mauzerrin te krahi”<sup>36</sup>.*

Ernest Koliqi e skalit Dodën si personazh që përjeton një krizë pas vrasjes së vëllait të tij. Ndërgjegjia e tij trazohet, lumturia për të nuk ekziston. Dilema dhe brenga që pushton shpirtin e tij pas vrasjes së vëllait nuk do shuhet më, sepse Doda në një farë mënyre vdes shpirtërisht. Pas veprimit të gjakmarrjes, Doda pret i palëvizshëm ardhjen e forcave ligjore që do ta dënonin për veprimin e kryer. “Qytetaria” e tij dorëzohet përballë fuqisë së shenjtë të mitit të gjakmarrjes. Por momenti final, i ngjashëm me dënimin mitik, ashtu si në tragjedinë greke, konsiston në çlirimin e pandërgjegjshëm nga pesha e fuqisë së epërme irracionale dhe në fitoren e besimit në qytetërim. Ai beson në qytetërimin e ri, prandaj dhe bëhet me ndërgjegje fli e këtij besimi të ri, e këtij miti të ri, duke paguar personalisht mungesën e fuqisë së ligjeve të shkruara në shtetin e ri shqiptar.

*“Doda-malsor, një djalëmalesh, një njeri me kulturë perëndimore, por në mendësi dhe në gen malësor, me hije mali në mendje dhe në zemër.*

*Nusha-qytetare, kodi civil fillon me Nushën të fejuarën e Dodës e cila nuk është nën efektin e hijes së malit dhe as të kodit, ajo është një vajzë qyteti, por që njeh mirë kodin kanunor dhe parandien të gjitha ngjarjet që do vijnë.*

*I ati i Dodës apa del si një personazh tipik i malit dhe kanunit”<sup>37</sup>.*

Te ky tregim kemi një përplasje mes kodit zakonor dhe kodit civil, pasi Doda ishte nën efektin e kodit civil, por nga ana tjetër duhej çuar deri në fund kodi zakonor për të ruajtur erzin e familjes. Për malësorin vlera që ka një familje është zbatimi i kodit zakonor<sup>38</sup>.

Besa dhe mikpritja kanë qenë vlerat më të çmuara dhe të respektuara në zemrën e çdo shqiptari. I lidhur më shumë me këtë konceptin e besës, pra të mbajtjes së fjalës së dhënë është pa diskutim burri dhe kjo dëshmi vertetohet që nga folklori shqiptar që ka shumë fjalë të urta të cilat çmojnë aspekte të ndryshme të besës, të rolit të saj, veçanërisht për rregullimin e marrëdhënieve të ndryshme ndërmjet shqiptarëve. Vlen vetëm të sjelim ndërmend disa shprehje që shpesh përmenden edhe sot e kësaj dite si: *“Detit i ka hije vala, burrit i ka hije*

<sup>36</sup>Sabri Hamiti, *Gjaku e Bajraku*, në: “Jeta e re”, nr. 1, Prishtinë, 1995, f. 26.

<sup>37</sup>Rovena Vata, *Miti i malit në letërsinë shqipe: Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Migjeni, Martin Camaj*, Naimi, Tiranë, 2013, f. 135.

<sup>38</sup>Rovena Vata, *Miti i malit në letërsinë shqipe: Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Migjeni, Martin Camaj*, Naimi, Tiranë, 2013, f. 136-137.

*fjala*”; *E humbe besën humbe gjithçka*”; *“Muri luan, besa s’luan*”; *“Ku është besa, aty është edhe shpresa”* etj. Sipas mendësisë së popullit tonë atë që bjerr besën nuk e treste as dheu. *Besa është një nga “perlat” më të vyera në trashëgiminë folklorike të njerëzimit*<sup>39</sup>.

Besa është një nga vlerat kulturore, në studimet sociologjike përkufizimi imendimtarit Robin Williams në lidhje me këto vlera shprehet: *“Vlerat kulturore janë koncepte të përgjithshme, janë kritere në bazë të të cilave anëtarët e një kulture përcaktojnë se çfarë është e dëshirueshme ose e padëshirueshme, e mirë apo e keqe, e bukur apo e shëmtuar*<sup>40</sup>.

Fjala e dhënë dhe besa janë pasqyruar mjeshtërisht në novelën *“Miku”*. Besa ka qenë tradicionalisht kod i pashkelur në malësinë shqiptare në veçanti, prandaj këto virtyte i ruajnë edhe personazhet e Koliqit besnikrisht. Te novela *“Miku”* Koliqi i kushton kujdes të jashtëzakonshëm besës dhe mikëpritjes. Shqipton rëndësinë e këtyre virtyteve për botën dhe popullin shqiptar, të cilat bashkë me burrërinë, urtinë dhe trimërinë i vënë në pedestal të moralit.

Burimi i së drejtës zakonore shqiptare duhet kërkuar në origjinën e shqiptarëve dhe në zhvillimin e tyre shoqëror e ekonomik gjatë shumë shekujve. Koliqi, te novela *Gjaku* dhe *Miku* bën të njëjtën vlerësim dhe analizë të imtësuar të gjendjes, duke përgjithësuar me mjete të shprehjes artistike shoqërinë shqiptare me peshën e kodit të lashtë juridik dhe mendësinë e kanunit.

Personazhi kryesor i novelës, *Miku*, duke ndihmuar gazetarin dhe duke mos iu bindur ligjit qytetas, nuk bën gjë tjetër, veçse mbetet pjesë e rrënjëve dhe e gjakut<sup>41</sup>.

Kështu Uc Lleshi pret dhe përcjell nga shtëpia e tij gjaksin, Gjok Vatën dhe gazetarin, Shefqet Kadia, për të cilin ishte zotuar se do ta zërë të gjallë dhe do t’ia dorëzojë pushtetit në Shkodër.

*“Këtë nder skam për ta harrue sa te jem Uc Lleshi- bani gazetari shkodran. “Tashti je i shpetuem,lum zotnia, përtej prronit asht toka e huej. Kam mëndue se prej kësaj gryke do të dilnin kapidanë e shumë drue që këtu mbrëndë do të lâ ndoshta edhe togerllëkun. Por, ani, s’ka gajlle: pa besë e pa miq s’ka ç’ka na duhet as jeta në këto malet tona. Udhambarë!”*<sup>42</sup>.

Kështu përfundon edhe kjo novelë e cila shpërfaq më së miri karakterin e fortë të shqiptarit edhe përballë fatkeqësive familjare.

<sup>39</sup>Zyhdi Dervishi, *Vështrime të kryqëzuara në det*, Jerusalem, Tiranë, 2003, f. 32.

<sup>40</sup> Williams Robin M, *American Society: Asociological interpretation*, Third Edition, Knopf, New York, 1970, f. 27.

<sup>41</sup> Dhurata Shehri, *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, Tiranë, 2006, f. 87.

<sup>42</sup> Të gjitha citimet në këtë pjesë janë marrë nga libri: Ernest Koliqi: *“Miku”*, në: *“Hija e maleve”*, Buzuku, Prishinë, 2003, f. 90-98.



Tregimi ndërtohet mbi kontrastin mes detyrës zyrtare dhe detyrimeve zakonore<sup>43</sup>.

*“Ucit i pikonte gjak plaga që kish të pambyllme në zëmër.*

*Gjaksin, që kërkoi kot një vjetë rresht nëpër vetmitë e bjeshkëve për t’i ra pushkë lules së ballit, qe, e kishte përpara. E zakoni e detyronte me e pritë e me bisedue me të si me mâ të shtrëjtin dashamirë, mbasi i kishte ra mik te shpia!”<sup>44</sup>.*

Bëhet e ditur që në hyrje se heroji është njeri i përkushtuar në punë. Gatishmëria e tij për t’iu përgjigjur urdhrave jo thjesht me fjalë, por me veprime konkrete, lidhet si me përkushtimin, ashtu dhe me faktin që ai ka ambiciet e veta për sa i takon profesionit.

*“Shqipnia ka zakone të çuditshme. Shtëpia e Uc Lleshit s’kishte njoftë kurrë kori. Kushdo që e kish mësy, kish qënë i sigurtë se gëzon proje deri në fikjen e në rrënimin e plotë të saj. Nderi i shtëpisë e zakonet e vëndit rrinin për Ucin përmbi çdo interesë, përmbi çdo urdhën qeverie e përmbi çdo ndiesi e arsye tjetër”<sup>45</sup>.*

Profili i Ucit në sferën e raporteve me shtetin dëshmon një pozitë të nderuar, e cila e bën të ndihet krenar, nuk mund të thuhet e njëja gjë për sedrën e tij si malësor e familjar. Me gjithë përpjekjet, nuk ka mundur akoma t’i marrë gjakun të vallait, një plagë e pambyllur kjo, q’i ia brente zemrën dit’ e natë.

*“Burrë i shkurtë, me shpatulla të gjâna e të fuqishme, kâmbët pak si të lakueme. Uc Lleshi, me gjithë që flokët s’i kishte fort të thinjun, diftonte së paku pesdhetë vjet të plotë. Por vizat energjike të fytyrës së djegun prej diellit e sytë si xhixha diftonin edhe se, për shpejti e guxim, nuk ia linte dalë një të riut. Njeri me influencë në atë pjesë të Malësisë ku banonte, kishte pasë prej qeversisë grada e shpërblime për me përfshi forcën e madhe të tij, që përndryshe mundtë ishte e dâmshme, në makinën e Shtetit”<sup>46</sup>.*

Kanuni ndërhyr jo vetëm me ligjet e tij që përcaktojnë sjelljen e individit, por dhe me mënyrën e formën e të shprehurit, me formulat karakteristike. Ai është pjesë jo vetëm e jetës malësore, por dhe e ligjërimit<sup>47</sup>.

---

<sup>43</sup>Shih: Laura Smaqi, vep. e cit., f. 46.

<sup>44</sup>Ernest Koliqi, novela, *Miku*, f. 90.

<sup>45</sup>Po aty, f. 92.

<sup>46</sup>Po aty, f. 87-88.

<sup>47</sup>Shih: Laura Smaqi, vep. e cit., f. 46.

Formulat miqësore të shprehura shoqërohen me një gjendje tepër të vështirë shpirtërore, që është e kundërt me fjalët që artikuloohen.

*“Në raki, të dy malësorët rivala, biseduen mbi gjithfarë punësh tue u ndëj larg, me hollësinë e zakonshme të tyne, çâshtjeve që mund ia prishnin qejfin, njânit ase tjetrit. Atij që i shifte të ndëjun kundroll shoqishoqit, tue pi duhan e tue shprazë gota rakie, kurrë nuk mund t’i shkonte mëndja që të nesërmen, me pasë për t’u ndeshë kund, ata dy burra do t’i mëshonin pushkë hekuri pa mëshirë njâni-tjetrit. I shkodrani dukej në kasavet; s’çelte gojë veçse me iu prgjegjë urimeve që i bânin në pije. Uci e Gjoka kuvënduen mjaft, pa u shikue gati kurrë ndër sy.*

*Kah e vona, mbasi kishin rrokullue një numër bukur të madh gotash, Gjokë Vata çoi të teten dhe iu soll shkodrani: -Për të mirë, zotni, pot a fail edhe unë një gotë. Hiç s’ke pse rri në mëndim tash që gjinde ndorë Uc Lleshit.*

Kanuni (mikpritja) dhe ligji, përplasen në mënyrë të heshtur me njëra-tjetrën në këtë novelë dhe zgjidhja apo zgjedhja e tyre bëhet krejt natyrshëm nga autori.

*Priç të mirë, Gjokë Vata, - ia priti ai tue zgjue prej gjumit. – Po më kânda me ndëgjue kuvëndin tuej, se a për mëndime më kanë lodhë vetëm deri sa mujta me mbrî te dera jote e në këtë shtëpi. E nuk kishte qënë masë administrative e gabueme, kjo, për atë kohë, pse qyshse Uci veshi uniformën, s’guxonte komitë mâ me u endë në ato ana edhe urdhënat e qeverisë u zbatonin mâ së miri. S’kish nën komandë gjendarmë të rregullt, por njerëz besnikë që mblidhte në rasë të nevojës. Këta ishin gjendarmët e tij”<sup>48</sup>.*

Prapë siç e thamë edhe më lart personazhi kryesor i novelës, duke ndihmuar gazetarin dhe duke mos iu bindur ligjit qytetas, nuk bën gjë tjetër, veçse mbetet pjesë e rrënjëve dhe e gjakut<sup>49</sup>.

*“Gjind që shkonin e u vritnin mbas tij, pa kurrëfarë shpërblimi, veç për hatër që i kishin e për ndera të vogla që atij i takonte me u bâmë në shehër e në mal. Edhe atë ditë, porsa u vojt lajmi, ia mbërrimë fluturim në oborr të kullës, të armatosun mâ së forti”<sup>50</sup>.*

Kulti i mikut zë vend të rëndësishëm në shtëpinë e malësorit. Edhe atëherë kur i zoti i shtëpisë është një funksionar shteti, ai prapë së prapë zbatoi rregullat e kanunit, Uc Lleshi

---

<sup>48</sup>Po aty, f. 88.

<sup>49</sup>Dhurata Shehri, *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, Tiranë, 2006, f. 87.

<sup>50</sup>Ernest Koliqi, *Miku*, f. 88.

respektoi traditën, duke mbrojtur gjakësin e të vëllait në votrën e tij familjare dhe duke e përcjellë atë që të mos i ndodhte asgjë në kufitë e lagjes së tij.

*“Feja kishte me qënë me e hetue e me zënë këtë dreq shkollarit. Kishim me e sjellë unë vetë në Shkodër, me e dorëzue atje edhe me thënë aqik në hyqymet që i ka ardhë koha me më bâ kapidan. Në më daltë me e krye këtë shërbim si duhet, kam të drejtë me e çelë gojën...”*

*“Këto mëndime e bënë Uc Lleshin në qef. Punët i shkonin gjithmonë mbarë, prandej kur i ngulej mëndja në një send ishte gati i sigurtë se, me pak sabër e marifet, do t’i dilte në krye. Ishte njeri me orë. Vetëm një gjâ nuk i eci deri në ato ditë e kjo, për têt, ishte plagë e pambyllun që ia brënte zëmrën ditë e natë. Vjetin para, shtëpia e Gjokë Vatës i kishte vra të vllanë, të anë e Mirashit, e me gjithë të orvatunit e të përpjekunit e tij e të mashkujve të shpisë ende s’kish qënë i zoti me ia marrë gjakun. Por s’ishte për t’u çuditë: shtëpia e Gjokë Vatës, e rivalit të përhershëm të Ucit në atë krahinë, ishte e fortë, edhe ajo me rreth të madh, e gjint e saj nuk mund të vriteshin udobisht”<sup>51</sup>.*

Ky malësor siç ishte Uc Lleshi, një nëpunës shteti, është tipiku i burrit dhe vlerave shqiptare, burrë i besës dhe i mikpritjes, pa marrë parasysh në këtë rast rrethanat që ia bëjnë edhe më të vështirë këtë rol.

Uci nuk është njeri modern, sepse në përballje me detyrën qeveritare dhe detyrimin ndaj Kanunit, ai, krejt natyrshëm, zgjedh, të dytin.

*“Në atë çast doli grueja prej odës së zjarrit e lajmueme nga zhurma e hapave për ardhje të tij.*

*– Kush âsht në odë të miqve? – e pyeti ai. -*

- Gjokë Vata...*
- -Kush? – përsëriti me zâ të plasun.*
- Gjokë Vata me një shkodran.*
- Uci u pré. Përqethje të ftofta ia mbuluen shtatin.*

*Gjaksi i vllaut në shtëpi të tij? A ishte ândërr e zhgjândërr? Përmbloodh krejt forcat e vullnetit dhe u shkund. Vari pushkën e vet bri tjerave dhe u mendue me u kthiellë në fytyrë.*

*Hyni. Miqt po rrinin me Mirashin.*

*- Mbrâmja e mirë, burra, e mirë se u ka prû Zoti.*

---

<sup>51</sup>Po aty, f. 89.

*Ata u çuen në kâmbë. Uci u mor grykë mâ parë me Gjokë Vatën, që ish moshatar i tij, por mâ i gjallë e me mustaqe që i shkonin dredha-dredha deri në veshë, e mandej me shkodranin. Ky dukej shumë i ri, ishte pak si i thithun dhe i zbehtë në fytyrë, veshë allafranga”<sup>52</sup>.*

Uc Lleshi edhe pse kishte si detyrë që të zinte gjaksin sipas parimeve të shtetit, ai i thotë atij se ti je në besën time pasi je në konakun tim dhe këtu je në shtëpinë e mikut dhe në shtëpinë e Zotit.

*“Para se me kapë bukën në dorë, Gjokë Vata, mbasi kishte mbërrë me e prû bisedën atje ku i duhej, tha:*

*- Zoti të rritët oxhakun, Uc Lleshi.*

*Dhe, tue shikue për të parën herë drejt e ndër sy, vijoi:*

*- Ky zotnia kurrë mâ ngusht se sot nuk na âsht gjetë në jetën e vet. Qeveria e kërkon e me bâ me e zânë... vaj halli i tij! Ma ka mësy shtëpinë e më ka ra në besë. Unë ta kam prû me ma marrë me ndore e me ma qitë shëndosh andej kufinit, pse e di mirë që, pa ndihmën tânde, kufinin, në këtë anën tonë, s’ka burrë që e kalon”.*

*“Pa besë e pa miq s’ka ç’ka na duhet as jeta në këto malet tona. Udhambarë!*

*Paç të mbarë e zoti të ruejttë, Uc Lleshi, - bani gazetari. Këtë nder s’kam për ta harrue sa të jemë. U përqafojnë të gjithë, një nga një, me têt. Ai zdeshi këpucë e çorapë e kapërceu prronin”<sup>53</sup>.*

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit gjendet një normë kulturore e cila përcakton se *“Shtëpia e shqiptarit asht e Zotit dhe e mikut”<sup>54</sup>.*

Kësisoj për nga rëndësia miku renditej i dyti pas Perëndisë, në një farë mënyre miku ngjitej në statusin e një gjysmëperëndie, për të cilin mikpritësi, qoftë edhe krejt i rastit, jo vetëm duhej të zbatonte me përpikëri kërkesat e “protokollit” të respektit, por edhe të rrezikonte gjithçka deri në jetën për të mbrojtur nderin e dinjitetin e mikut.

<sup>52</sup>Ernest Koliqi, novela, *Miku*, f. 90.

<sup>53</sup>Po aty, f. 94.

<sup>54</sup>Kanuni i Lekë Dukagjinit, Neni 602.

Në nenin 643 të Kanunit të Lekë Dukagjinit thuhet: “*Po ta vuni kush mikun në lojë a t’a shau, ti do t’a mkambësh nderën e mikut me rrezik të jetes s’ate. Kanunet shqiptare parashikonin ndërshkime të rrepta dhe poshtëruese për të gjithë ata që nuk respektonin sa e si duhet mikun dhe sidomos për ata që prisnin mikun në besë, qoftë ky edhe hasmi i tij.*” Sipas nenit 648 të Kanunit të Lekë Dukagjinit ai që prët mikun në besë grihet (= vritet) katundisht dhe shkon gjak-hupës.

Edhe dijetarë të huaj kanë vënë në dukje se në kulturën tradicionale shqiptare ndërshkohej rreptë çdo cënim i mikut, i personalitetit të tij. “Hospitaliteti (=mikpritja)- shkruan Xhorxh F. Williams –është në kulmin e tij në Shqipëri. Një atakim po t’i bëhet mikut në çdo mënyrë qoftë është një çnderim i madh për të zotin e shtëpisë e për gjithë fisin e tij. Ai që gradit ose vjedh mikun simbas zakonit të vendit dënohet shumë rëndë, ose me vdekje, ose nxirret jashtë fisit”<sup>55</sup>.

Ndërsa në librin “*Shqipëria e epërme*” Edith Durham përshkruan këtë histori interesante: një malësor nga një krahinë e largët zbret në Shkodër për t’u ndeshur me burrin më trim të qytetit, të cilin ai nuk e njihte. Rastisi që ai të ndalonte te dyqani i shkodranit me të cilin do të bënte duel. Vendasi, megjithëse nuk e njihte, i bëri të gjitha nderet mikut, i cili, pas disa ngurrimesh i tregoi përse kishte ardhur. Disi i zënë ngushtë malësori po ndërronte mendje. Por shkodrani nguli këmbë që dueli të bëhej me qëllim që malësori të mos koritej në sytë e bashkëfshatarëve të tij, të cilët e dinin qëllimin e këtij udhëtimi. Malësori qëlloi dy herë me pistoletë dhe eplagosi lehtë rivalin. Ndërsa shkodrani nuk pranoi ta qëllonte mbi mikun. Pasi përshkruan për tiparet me të vërtetë fisnike të karakterit të shqiptarit: detyra e mikpritjes, shenjtëria e mysafirrit dhe trimëria<sup>56</sup>. Ligjet të mikpritjes – shkruan Edith Durham – janë më të sigurta se armët<sup>57</sup>.

Këto norma kulturore që rregullonin gjithë sistemin e marrëdhënieve me mikun dhe funksionet e tij, në evolucionin e tyre të ngadalshëm kanë qenë të gjithëfuqishme për vite e shekuj me radhë, veçanërisht në krahinat e papushtuara të Shqipërisë.

---

<sup>55</sup>Williams Xhorxh Fred, *Shqiptarët*, Shtëpia Botuese, Argeta – LMG, Tiranë, 1999, f. 27.

<sup>56</sup>Shqipëria e Epërme, 1990, f. 201.

<sup>57</sup>Po aty, 1990, f. 86.

## 1.2. Kodi i fantastikes në novelat “Kërcimtarja e Dukagjinit”, “Nusja e mrekullueshme”, “Zâna e fundme”

Në rrafshin e fantastikes, padyshim që dokumentimi i veprës së Koliqit ofron një interes specifik, qoftë për temat e trajtuara (veçanërisht në librin: “*Hija e maleve*”), qoftë edhe për procedimin e hulumtimit psikologjik, e zhbirimit dhe zbërthimit deri në imtësi të botës së brendshme të personazheve, që rezulton të jetë një botë paralele me realen, e mbushur me ndjesi, përfytyrime dhe gjallëri që tejkalojnë atë çka mund të shihet apo preket nga realiteti.

Bota e përrallës është unike e përbërë nga kjo botë dhe ajo botë (bota tjetër). Kalimi prej njëres në tjetrën bëhet pa vështirësi, sepse personazhet migrojnë<sup>58</sup>.

E vetmja mënyrë që njeh mirë letërsia është rrëfimi<sup>59</sup>, Koliqi si prozator tregohet mjeshtër i madh i shtjellimit të strukturës së tekstit poetik dhe i strategjisë së rrëfimit; përfton forma të përshtatshme të rrëfimit dhe të komunikimit artistik të veprës letrare dhe ndikimin estetik të saj me lexuesin<sup>60</sup>.

Dy pjesë të fantastikes që mund të vërehen tek Koliqi janë: e mrekullueshmja, mitologjika, te bota e pasur e fantazisë dhe imagjinatës kolektive popullore (Zanat, orët, shtojzovallet), që hyjnë e njëjtësohen me personazhe reale apo historike në vepër (dhe e pamë më lart që ky është një element dallues dhe identifikues i fantastikes), si dhe te reticënca e narracionit, përmes një teknike rrëfimtare moderne, ku të pathënat janë më shumë nga ato që tregohen, ku bota e brendshme është një zë më i fuqishëm, edhe pse i heshtur, në ekuilibrin e raporteve të vetë tekstit letrar.

Tregimet më të mira të Koliqit që mbeten mes mitit dhe fantastikës janë tregimet “*Kërcimtarja e Dukagjinit*”, “*Nusja e mrekullueshme*”, “*Zana e fundme*”, të cilat përshkohen nga ide, ikona, imazhe të ardhura nga eposi heroik, nga përrallat e baladat, nga legjendat dhe traditat zakonore, si dhe nga idiolekti e sociolekti ambiental autorial. Thënë në stilin e Koliqit, në tregimet, novelat dhe rrëfejtat e tij, është rindërtuar jeta shqiptare më frymën shqiptare<sup>61</sup>.

<sup>58</sup>Umberto Eco, *Si shkruaj*, AIDK, Prishtinë, 2003, f. 34.

<sup>59</sup>Zherar Zhenet, *Figurat*, Rilindja, Prishtinë, 1985, f. 55.

<sup>60</sup>Anton Berisha, *Ernest Koliqi, poet dhe prozator*, Toena, Tiranë, 1997, f. 65.

<sup>61</sup>Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe oraliteti, Kuteli, Koliqi, Pashku*, AIDK, Prishtinë, 2002, f. 55.

Pikërisht këto elemente më së shumti i gjejmë në novelat “Nusja e mrekullueshme”, “Kërcimtarja e Dukagjinit” dhe “Zana e fundme”. Në fakt, mitologjia dhe folklori, zënë një vend nderi në tërë veprën letrare të tij.

Lidhja e shkrimtarit me mitologjinë nuk është një lidhje e sajuar me mund në rastin e Koliqit, por një lidhje që vjen natyrshëm, për të cilën nuk është e nevojshme të studiosh thellësisht ç’është miti më tepër se ç’është e nevojshme të dëgjosh e të kapësh me intuit atë që s’mbetet thjesht problem i një kohe, por i të gjitha kohërave, atë që edhe pse shekujt ikanë kaluar sipër, ende mbetet si pikëpyetje në ndërgjegjen e njerëzimit<sup>62</sup>.

Novela “Kërcimtarja e Dukagjinit” është një novelë në kufi të përrallës dhe legjendës. E gjithë struktura dhe zgjidhja e saj e ndjekin një procedurë artistike, që mbështetet në të pamundurën dhe të mrekullueshmën. Në këtë vepër jemi në botën e mrekullive të zanave si dhe në shtratin ë trashëgimisë kulturore e shpirtërore të shqiptarëve të vjetër, mbi të cilin shtrihet fantazia krijuese e Ernest Koliqit. Mbesa e Lekë Dukagjinit është një vajzë e bukur dhe hyjnore, por aq përtace sa ka brengosur tërë familjen e fisin.

*“Ishte mbesë e Lekë Dukagjinit. E âma ankohej me të gjithë për at kryq qi i u donte me barun. Tashti ndodhi qi Mbreti i Shqiptarëve, Skanderbegu, mbas një lufte të fitueme kundra Tyrqve, grishi në Krue gjith Parsin e Shqipnis për me kremtue at ngadhënjim armësh. Lekë Dukagjini ishte i thirrun ndër mâ të parët...”<sup>63</sup>.*

Kur Skënderbeu po festonte një fitore kundër turqve dhe bën një gosti për prijësit në Krujë, mbesa e Lekës, përtacja e tmerrshme, ngrihet nga shtrati, i hipën kalit dhe, gjatë gjithë udhës për Krujë, i mahnit të gjithë me lodrat e saj, madje i mund edhe meshkujt.

*“Paska qënë dikur në Dukagjin një vajzë mrekullisht e hijshme. Për në dhé tonë asokohe mund të thohej se nuk kishte si me e gjetë një tjetër mâ e bukur. Hijeshia e fytyrës e përsosja e gjithë pjesëve të trupit, linte për një copë herë pa mend para saj këdo që e shifte së pari. Kryet, krye perëndeshe: duert; duer zânash: kâmbët aq të vogla e të lehta sa me t’u bâ hê-hê po qesin fletë e po çojnë fluturim në ajri. Me dy fjalë: një kryevepër natyre”<sup>64</sup>.*

Në ditën e fundit të kremtimit në Krujë mbreti ofroi dhuratën më të vlefshme për vashën që do të kërcente më të bukur.

---

<sup>62</sup>Rovena Vata, *Paradigma e mitit të malit dhe fantastika te Koliqi*, në: “Alternativa”, revistë për kulturë dhe shkencë, Lublanë, 2013, f. 84.

<sup>63</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Kërcimtarja e Dukagjinit*, në: “Hija e maleve”, Buzuku, Prishinë, 2003, f. 85.

<sup>64</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Kërcimtarja e Dukagjinit*, f. 77.

Qendërzimi i zanës si element tipik i folklorit shqiptar në tregimet e Koliqit do të nxitej nga synime të caktuara, të cilat zbulohen drejt, vetëm potë kihet parasysh e gjithë vepra letrare e Koliqit në tërësi e bashkë me të dhe shkrimet me karakter kritik dhe publicistik që ai ka lënë<sup>65</sup>.

Në analizën që do u bëjmë këtyre tregimeve kemi të bëjmë edhe tiparet e përrallës dhe që duhet të theksojmë se të gjitha kategoritë e përrallës në një mënyrë ose në një tjetër i nënshtrohen atyre të tregimit, duke ndryshuar në varësi të këtyre të fundit, dhe ajo që vihet re është “*mbivendosja e dy strukturave dhe arritja e një strukture të tretë, që s’është as tregim dhe as përrallë*”<sup>66</sup>.

Aty shfaqet e para Tyrkina. Mbas saj dhe shumë vasha të tjera. Kur mbreti u bë gati t’i jepte çmimin turkeshës, Lulja e Dukagjinit doli në mes të shtrojës. Lulja e Dukagjinit i mahnti të gjithë. Ajo fitoi, kurse lodrat e hokat e saj nuk pushuan as gjatë udhës së kthimit për në Dukagjin, kur të gjithë ishin të lodhur.

*“Si u këshillue me bajloza, Mbreti ndau me ia dhânë çmimin e premtuem turkinës së panjohun e ishte kah jepte udhën të shpallej ky vëndim, kur një kërcimtare e papritun e ndaloi tue dalë në mes të shtrojës.*

*Ishte princeshë Lulja, mbesa e Lekë Dukagjinit.*

*Si u bâ? Çka ndodhi?*

*Porsi hyria malësore çoi duert e luejti kâmbët, një habi e âmël kapi gjithë shpirtnat. Nëpër tânë solonin u ndie një âmë lulesh mali dhe si një gurgullim krojesh të ngrîta.*

*Sy njeriu s’kish pa as valle mâ të mrekullueshme as kërcimtare mâ të bukur. Lëkura e fytyrës së saj ngjante me endun me rreze e fletëza prilli. Trupi i vërgjilët përhapte anë për anë një njomsî si lule që sapo ka çelë.*

*Të gjithëve iu bâ se shifshin rreth saj tue lulëzue e tue u shfletëzue, si në ândërr, lulishta madhështore. Ishte një apoeozë lulesh: lule të dënduna të panjehuna iu çelnin nën kâmbët e*

---

<sup>65</sup> Laura Smaqi, *Funksioni poetik i zanës në tregimet e Ernest Koliqit*, në: “Studime filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000, f. 81.

<sup>66</sup> Dhurata Shehri, *Përralla si tregim brenda tregimit*, në: Akte të Konferencës shkencore “Letërsia si e tillë, Toena, Tiranë, 1996, f. 223-228.



*lehta, reshëshin mbi flokë të lëshuem, dridhëshin ndërmjet gishtave të bardhë, derdhëshin mbi trup hyjnor*<sup>67</sup>.

Lulja falë Zanave do ta fitojë vendin e parë në garën e cila ishte organizuar pas fitores së Skënderbeut kundër turqve e në të cilën garë merrnin pjesë edhe kërcimtarja turkinë. Ky gërshetim i botës mitike më atë reale ka si synim paraqitjen e botës shqiptare me të gjitha ngjyrat e saj. Të nesërmen ia behu një princ i njohur për t'i kërkuar dorën, por Lulja e bukur nuk qohet nga shtroja, ajo është sërish përtace.

*“Të nesërmen një lajmtar i papritun e zgjoi heret Zogën. Lekë Dukagjini e thirrte për një punë me rëndësi të madhe. Ia kishte befë në kështjellë një princ i ri, nga shtëpia e Muzakajve, që kërkonte me e marrë Lulën e donte me u fejue aty për aty. Kërcimi i pashoq e kishte bâ me u çmëndë mbas saj, e ai kish vrapue për të arrijtëi pari, sepse ishte i sigurtë se tjetër dëshirtarë do t'u paraqitnin për së shpejti.*

*Zoga, si mori vesht punën, ngau me zgjue të bijën. Por kjo gërhiste tue fjetë e s'ishte send që e luente vëndit. Mbasi e shkundi e âma mirë e mirë, në fund Lulja u ngrit me sy të turbullt e me një shprehje mërzie në skaje të buzëve.*

*Çou-i biri Zoga-se kanë ardhë me të lypë për grue. Ajo s'e tund asnjë fije, por mori me u veshë kadal me plogështinë e zakonshme.*

*Mâ shpejt, he qyqe! Ku ma le zhdërvjelltësinë që kishë në kërcim-bâni e âma tue e nxitë.*

*Ku? Si?-pyeti vajza e një habi e madhe iu piskue në fytyrë*<sup>68</sup>.

Pra ku qenka misteri? Kjo mrekulli që gjendet përtej jetës reale, në përrallë, shndërrohet në këtë tregim në ushqim shpirtëror, që synon e arrin mrekullinë.

*“Çka kishte ndodhë?*

*Mos i hap sytë e bukur edhe mâ tepër se i ke hapë; qe, me dy fjalëpo ta hjeki kureshtjen. Zânat e Dukagjinit, për me i qitë zânin maleve të tyne, kishin nda që njëna prej sosh të merrte fytyrën e trupin e Lulës e të shkonte në Krujë në vend të saj, me sa që këtë, tue e plandosë nënjë gjumë të rëndë, e kishin vû me fjetë në banesën hyjnore ku ato jetojnë. Mandej e kishin çue prap në shtëpi, natën, pranë së âmës, kur shoqja e tyne ktheu nga trimfi i Krujës.*

*Puc, Zanat bâjnë shpesh kësa lojnash!...*<sup>69</sup>.

<sup>67</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Kërcimtarja e Dukagjinit*, f. 82.

<sup>68</sup>Po aty, f. 84.

Kjo është pikërisht shtresa mbizotëruese e novelave të Koliqit te libri *“Hija e maleve”*.

Në fakt, tërë vepra nis me novelën *“Nusja e mrekullueshme”*, e cila vë në pah mentalitetin tipik shqiptar, besëtytnitë mitike të cilat mbase edhe janë konsumuar si ngjarje të vërteta në shoqërinë e kohës. Ngjarjet që lidhen me tragjicitetin që pëson Leka, si pasojë e dashurisë me nusen e mrekullueshme, Zanën, që i shfaqet gjatë kohës kur kulloste bagëtitë, ia rrëfen prifti i fshatit, Don Marku, të riut intelektual që ishte shkolluar jashtë Shqipërisë.

*“Jam martue me një shtojzavallë e përnatë bie me të. E ia kallxoj fill e për për martesën e çuditshme”*<sup>70</sup>.

Ngjarjet që tregojnë priftin në rrëfimin e tij në lidhje me tragjikun që pëson Leka, në psikën e të riut shqiptar të shkolluar në një metropol evropian, ngrejnë dilema të mëdha dhe, edhe pse si personalitet ishte “formuar” larg ambientit, këto rrëfime kishin lënë përshtypje të thellë tek i riu intelektual.

*“Prifti më shikonte ndër sy. Un i ula për mos me m’u hetue në ta përshtypja tepër e thellë qi më kish ba tregimi. As nuk ia solla pyetjet e shuma qi ishin, kah më delshin prej goje”*<sup>71</sup>, është paragrafi me të cilin pasqyrohet bota emocionale e Lekës në këtë novelë.

Prania aq e madhe e formave të rrëfimit popullor: kallëzimit, përrallës, mitit, mitikes, gojëdhënës, e të tjera që gërshetohen poetikisht, përbrenda prozës tregimtare të Koliqit kanë funksion të shumfishtë ndërtimor dhe njëkohësisht paraqesin udhën e vetëdijësuar të pritjes së këtij shkrimtari në fushën e letërsisë popullore, si gjetje dhe mbitheksim i njërit prej burimeve themelore të autorit.

Në mitologjinë shqiptare ka ekzistuar përfytyrimi për disa krijesa femërore që janë quajtur Zana, të cilat e kanë origjinën nga hyjnia e natyrës së virgjër.

Prapa figurës së Zanës, me atributet e saj më qenësore, vërejmë një hyjni të maleve, të natyrës së virgjër, mbrojtëse të bimësisë dhe të kafshëve të egra, gjahtarë hyjnore. Në besimet popullore Zana paraqet në pamjen e një gruaje të re a të një vajze me bukuri të përkryer, simbol i bukurisë.

Zakonisht gjenden në jetesë a në punët e tyre tri Zana bashkë, e secila prej tyre ka funksione të saj të veçanta, por gjenden dhe dy ose dhe një e vetmuar.

Forca e tyre mishërohet në dhinë e egër a në tri dhi të egra, në sorkadhen, në pëllumbin a në rosën e egër. Po ua mbyte atributet përkatëse, sipas rastit, ato nuk kanë më forcë dhe mund të pëlcastin menjëherë<sup>72</sup>.

---

<sup>69</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Kërcimtarja e Dukagjinit*, f. 84-85.

<sup>70</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Nusja e mrekullueshme*, në: *“Hija e maleve”*, Buzuku, Prishtinë, 2003, f. 23.

<sup>71</sup>Po aty, fq.17.

E njëjta figurë mitike haset në folklorin tonë, të cilat njihet si: Ksheta, ose Nusja e Bukur, Cuca e Liqenit, Nusja e Ujit, Zana e Ujit. Ajo rri në ujë e herë-herë del në breg e krihet, ngrohet në diell dhe është shumë e bukur. Prindërit porosisnin fëmijët: “*Mos u lani në hurdhat me vorbull nën ujvara se u kap e u mbyt Ksheta*”<sup>73</sup>.

Krijimtarinë letrare të Koliqit e karakterizon teknika e përsosur narrative, gjithsesi ngjarjet në novelat e tij kanë një rrjedhë të kapshme, logjike. Personazhet e këtij autori janë tipizuar aq mirë sa që lexuesi krijon lidhje emocionale me protagonistin e caktuar. Përveç botës reale, Ernest Koliqi na mishëron edhe me botën e pafundme fantastike. Fantastikja në veprën e tij nabëhet aq e prekshme sa duket sikur e kemi afër.

Në tregimet e Koliqit gjejmë një botë të lidhur gjenetikisht me mitologjinë. E themi këtë sepse i përkasin një bote tjetër apo magjive, por ata kryejnë rite që kanë forca hyjnore të Diellit e të Hënës, festojnë festa që origjinën e kanë nga mitologjia<sup>74</sup>.

E magjishmja dhe fantastikja te Koliqi del haptazi te ndikimi dhe efekti që ka bota mitologjike e Zanave, si muza të përfytyrimit individual dhe frymëzim krijues brenda autorit. Studiuesi Anton Berisha në veprën: “*Ernest Koliqi prozator*” e paraqet kështu gërshetimin e fantastikes me Koliqin:

“*Lidhja e Ernest Koliqit me artin e fjalës ose, të themi, me gjuhën e poezisë, me Zanën poetike, është e hershme. Sipas të dhënave që na i ka lënë vetë, edhe si fëmija ai kishte filluar të ndjejë e ta përjetojë artin e fjalës, forcën dhe madhështinë e tij: “Qysh fomi Zana, tue më puthun, m’a vuri zhigun e vet në ball...u orvata mjaft m’u lirue prej robnis muzikore të saj, por më kot për arsye se ajo...[...]m’i grabiti sytë e m’i lëshoi mbi disa vegime të cilat ia tretën shijën, qysh atëherë, jetës së zakonshme*”<sup>75</sup>.

“*Zana e Fundme*” është një tjetër novelë përbërëse e vëllimit “*Hija e maleve*” të Koliqit në të cilën fantastikja jeton në të gjitha përmasat e saja. Fjalja që fillon novelën: “*Sikurse do ta keni dëgjue sa herë e herë vendi ynë*” është e njëjtë me formulat e ligjërimit përrallor “na ishte njëherë” duke treguar afërsinë e ligjërimit të saj me llojin e përrallës fantastike.

“*Zanat e Dukagjinit, për me i qitë zanin maleve të tyne, kishin da qi njana prej sosh të merrte fytyrën e trupin e Lules e të shkojnë në krue në vend të saj, më sa qi këtë, tue e plandosë në nji gjumë të randë, e kishin vu me fjetë në banën hyjnore ku ato jetojnë. Mandej e kishin çue*

---

<sup>72</sup>Rovena Vata, *Paradigma e malit dhe fantastikja te Koliqi*, vep. e cit., f. 85.

<sup>73</sup>Mark Tirta, *Mitologjia ndër shqiptare*, Mësonjëtorja, Tiranë, 2004, f. 134.

<sup>74</sup>Rovena Vata, *Paradigma e malit dhe fantastikja te Koliqi*, vep. e cit., f. 86.

<sup>75</sup>Anton Nikë Berisha, *Ernest Koliqi poet dhe prozator*, Botimet Toena, Tiranë, 1997, f. 21.

*prap në shtëpi, natën, pranë s'amës, kur shoqja e tyre ktheu nga triumfet e Krues. Puc, Zanat bajnë shpesh këso lojnash!"*<sup>76</sup>.

Në epokën e teorisë sociologjike miti gjen një bazë të parë reale, një reale shoqërore, por mendimet për të ndryshojnë në varësi edhe të rrymave të studimeve të mëvonshme, derisa arrihet në një konstante të përgjithshme, sipas të cilës miti parashtron: ngjarje, shembuj, modele<sup>77</sup>.

*"Prrallat janë tisa të hollë qi mëshefin të vërtetën. Prandaj ksaj qi po u kallzoi, duhet t'i besoni"*<sup>78</sup>.

Nënovelen *"Zana e fundme"* nëpërmjet zanës si shpirtëzim kombëtar arrin të shprehë qenësinë e këngës si qendresë, si ekzistencë<sup>79</sup>.

*"Sikurse do t'a keni ndëgjue sa herë e herë, vendi i ynë motit ishte an'ana kangatare. Ç'do kreshtë e kaltërt, ç'do she gurgullues, ç'do zabel i lulzuem kishte Zanën e vet. Ishin projset e Shqipnis. Ato rrijshin gati me largue mjerimet e të zezat qi merrshin me i u afrue popullit shqiptar. Ndër mëngjese të qarta endshin valle maleve e fushave për me ndjellë të mira mbi komb qi asohere, për hirin e tyre, ishte fatlum"*<sup>80</sup>.

Zanat dhe orët, që haseshin aq shumë në krijimtarinë e Fishtës, ishin të kudogjendura edhe në tregimet e vëllimit *"Hija e maleve"* si matrice subjektsh që arrinin të mbanin të tendosur vëmendjen e lexuesit. Ato qenie të mitologjisë shqiptare vinin në prozë të Koliqit për të hapur të gjitha tiparet, me të cilat i mvishte mënyra popullore e të menduarit dhe e të shpjeguarit të jetesës: qiellore, shituese e të pakrahasueshme në bukurinë e tyre dhe në lumturinë që mund të falte ajo bukuri, po edhe të pamëshirshme kur u shkelej fjala që kishin kërkuar dhe u ishte dhënë, bartëse të palcës dhe të shpresës kombëtare si në rastin që po citojmë më poshtë<sup>81</sup>:

*"Kur Zanat e panë ujin e kulluet të gurrave përzie me gjak të fatosave, rudinat e blerta shkretue nga thembra e Aziatikut, tempujt e ndritshëm shëndrrue në burgje kualsh, vashat*

<sup>76</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Kërcimtarja e Dukagjinit*, f. 92.

<sup>77</sup>Adem Jakllari, *Histori e mendimit etnologjik dhe mitologjik*, Tiranë, 2003, f. 168-192.

<sup>78</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Zana e fundme*, f. 116.

<sup>79</sup>Anton Nikë Berisha, *Ernest Koliqi erudite i rrëfimit artistik*, pasthënie e librit "Ernest Koliqi", vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1995, f. 459.

<sup>80</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Zana e fundme*, f. 116.

<sup>81</sup>Ali Xhiku, *Letërsia shqipe si polifoni*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Letërsisë dhe i Gjuhësisë, Dituria, Tiranë, 2004, f. 219.

*arbnore robnesha në shatorret e të huejtit, u shkrehën në një vajë qi s'donte me pasë mbarim*”<sup>82</sup>.

Studiuesit janë të një mendje për të pranuar se veprat letrare, në një pjesë të mirë të tyre, përbëhen prej një lënde të marrë nga një traditë e dhënë kulturore<sup>83</sup>.

*“Qëndresa e disprueme e kreshnikve të fundëm u dha Zanave landë me këndue ndonji kangë të cilla delte, po, e përzieme me vajë, por ishte me gjith këtë ngushullim për shpirtinat e tyne*”<sup>84</sup>.

Njësimi shpirtëror e kulturor i botës shqiptare është i domosdoshëm, sipas Koliqit, edhe për një arsye tjetër: për të kapërcyer prapambetjen relative të kombit shqiptar, dhe përtë fituar me përpjekjet të gjithanshme kohën e humbur, duke mundësuar kështu pas një kohe ecjen krah për krah me kombet e tjera të qytetëruara<sup>85</sup>.

*“E Zanat s’patën as mbi ça me qa as mbi ça me këndue, përse ato qajnë e këndojnë vetëm mbi sende të bukura e të mëdhaja; e madhniya e bukurija kishin mbarue në dhen e shqipeve qyshse të bijt e saj s’e njihshin ma njani tjetrin vlla. Kur kanga e vaji, qi janë ushqimi i tyne, erdh tue u mungue, Zanat zunë m’u mërzhitë. Mërzhija i mbyti një nga një. Vdiqën. Por, tue qenë se trupi u qëndron i pahumbshëm e i njomë gjatë moteve, deka e tyne i shemlleu një gjumë të randë. Vetëm një mbet gjallë: kangatarja ma e mirë. Ajo mbështolli trupat e adhureshëm të Pajtoreve të rudinave në tisa të ndërpushëm, endë me rreze hane dhe me fletëza drandofillje, e i vendosi rrjesht e rrjesht në një shpellë të shkëlqyeshme kristali*”<sup>86</sup>.

### **1.3. Elementet etnologjike dhe psikologjike në novelën “Se qofsh, pleqnofsh”**

Mbi letërsinë e Ernest Koliqit, depërtimin psikologjik të tij deri në shtresat e nënvetëdijes, kritika ka hulumtuar mjaftueshëm, duke shpjeguar modernitetin dhe risinë e këtij mekanizmi, edhe falë një ndihme të ardhur nga psikanaliza freudiane e cila u zgjerua në mënyrë të përgjithësuar sidomos pjesën e parë të shekullit XX.

---

<sup>82</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Zana e fundme*, f. 117.

<sup>83</sup>Yves Chevrel, *Letërsia e krahasuar*, Tiranë, 2002, f. 88.

<sup>84</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Zana e fundme*, f. 117.

<sup>85</sup>Enver Muhametaj, *Ndihmesa të Ernest Koliqit në mendimin teoriko-letrar shqiptar*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2008, f. 59.

<sup>86</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Zana e fundme*, f. 117.

*“M’u hiq sysh...i briti mâ vonë e shkroi e ra ke votra. E vërteta ishte mâ e zezë se terri i vorrit. Si kallzohej Sufës, tashti? Lajmi do të ishte vdekje për të. Madje, mâ për nderë do t’ia kishte dijtë ai, kujdo, me i pasë ra pushkë lules së ballit se sa me i kallzue atë rrezik shnderues. A mund t’iu mëshifte një turp i tillë? Filja kërkoi, kërkoi gjatë me vete, për me shpëtue të bijën, mënyrën si me ia mëshefë të shoqit, por mâ në fund e la të mëndim; s’ish punë që bâhej kurrsesi: duhej kallzue me doemos”<sup>87</sup>.*

Ernest Koliqi e pasuroi edhe vetë sonetin me krijimet e veta, duke e begatuar traditën shkodrane, po edhe mbarë poezinë shqipe<sup>88</sup>.

Por ajo që konsiderohet më me interes në studimin tonë mbi fantastiken është referimi apo kontakti i Koliqit me Frojdin, mbi një tjetër shtyllë mendimi të këtij autori: koncepti i “të çuditshmes turbulluese”.

*“Sufa, kur ajo mbeti me lot për faqe e tue u dridhë ia rrëfeu fajin e Mines, mbet si i ngrimë e s’qe i zoti me qitë fjalë prej goje. Në fund, u trand. Sytëi ndritnin nga idhnimi e mënia.*

*Ku âsht?-pyeti me zâ të shqyem tue u çue me hov.*

*Filja ran ë gjûj para tij dhe ia kapi kâmbët.*

*Aman, pashtë sytë e ballit, mos i bân gjâ!*

*Ku asht?-pyeti ai edhe mâ rreptas e u nis të dali ta kërkojë.*

*Andej, në odë të miqve-bâni Filja me një fije zânit.*

*Sufa u turr në atë anë. Grueja e shkretë iu vû mbrapa.*

*Vajza, kur e kish ndëgjue të anë tue ardhë si duhia, ish strukë në një qoshe të odës si njajo gjâja e zânun ngusht që prët të ramit e mortshëm. I ati e kapi për krahi me tërbim dhe e ngrehi zharg deri në mjedis të odës tue vikatë:*

*Fol, sërvinë që më ke qelbë konakun, fol: kush âsht ai?*

*Ajo nuk bâni za. Dridhej e rrinte me sy për dhé, bardhë si pecan ë fytyrë”<sup>89</sup>.*

Le të përpiqemi ta shohim më në detaje këtë koncept dhe pastaj të përpiqemi të bëjmë një verifikim të tij në disa nga tregimet e sipërcituara të Ernest Koliqit.

<sup>87</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Se qofsh pleqnofsh*, f. 66-67.

<sup>88</sup>Milazim Krasniqi, *Idealizimi konceptual dhe praktika modeste e Koliqit*, në: “Soneti në poezinë shqipe”, Prishtinë, 2005, f. 152-159.

<sup>89</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Se qofsh, pleqnofsh*, f. 66-67.

Në novelën “*Se qofsh, pleqnofsh*”, Koliqi derdh tërë fantazinë e tij prej një njohësi të thellë të gjithçkaje që ishte shqiptare, për të na dhënë karaktere tipike të Malësisë së Shkodrës, situata konkrete herë-herë të dhembshme të një mentaliteti arkaik me të cilin karakterizoheshin malësorët shqiptarë.

*“Kërcnueshëm e kapi me të dyja duert, e ngriti përpyetë e desht me ia përplasë kryet në mur të odës, por e âma, tue qá me të madhe, u hyni ndërmjet. Ai e lëshoi, tue e hedhë në anë si një grumbull zhelesh. Goja i qiste shkumbë. Tâmathat po i pëlsitnin së rrahuni.*

*Mbylli sytë pastaj i hapi dhe i solli rrotull.*

*S’iu bânte me i besue vetes; i bâhej si me e pasë zânë ângthi në gjumë.*

*Kush mund ti priste pëshpëritjet e gojëve të këqia të malit? Turpi ia kishte mbulue shtëpinë. S’kishte mâ sy e faqe me dalë në kuvënd të burrave”<sup>90</sup>.*

Te novela “*Se qofsh, pleqnofsh*”, kemi dy rrafshe të forta diskursive, me prejardhje etnologjike dhe psikologjike. Prerja mes këtyre rrafsheve është mjaft e vështirë të bëhet në mënyrë strikte. Është pikërisht diskursi psikologjik ai që e përplotëson si brum idesh e motivesh skemën e njohur, në dramë dashurore mes dy të rinjsh<sup>91</sup>.

Mina, e bija e Files dhe Sufës, mbetet shtatzënë pa dijeninë dhe pa dëshirën e prindërve dhe për një mëkat të tillë, ajo do ta pësojë në mënyrën më tragjike: vritet nga i ati.

Por tragjikja arrin kulmin kur Hajdar Liti kërkon gjakun e fëmijës i cili ishte flijuar ende pa dalë në jetë.

*“Zakone shumë të mira, lum Sufa, ka kjo Shqipnia e jonë. Një ndër tjera âsht që ia vême borxh vrasit me i çue fjalë shtëpisë së të vramit se ku duhet ta kërkojnë gjakun. Burrat kështu e kanë!...Pse? A nuk të duket burrni me dalë e me thânë, kur vrasa ka mbetë në terr: “Mos u bier, se gjakun e ke të unë? Si thue? Edhe kur s’âsht punë vrase, por një çfarëdo faji.*

*Sufa mori frymë mâ lirisht. Faji që ai donte me ndeshkue nuk do të hupte në terr, sikurse kish pasë frigë. Ia bleu fjalën mikut para se ky të fliste. Unë kam ardhë me të kallzue fajtorin.*

*Sufa mori vesht me të parën se Hhalil Zeneli tjetër s’ish veçse lajmtar i dërguem prej fajtorit për me u zbulue. Dhe, si shqiptar i mirë që ishte, u gezue në fund të shpirtit që kish ballë për*

---

<sup>90</sup>Po aty, f. 68.

<sup>91</sup>Kujtim Rrahmani, *Intertekstualiteti dhe oraliteti*, E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku, AIKD, Prishtinë, 2002, f. 63.

*ballë një anmik trim: në armiq të dobët merret gjaku pa qef.. Këto sende i mëndoi, por gjâ nuk tha: priti mbarimin e fjalëve të Halilit:*

*Ky vijonte:*

*Kur tagri i gjakut âsht i açikshëm, mjafton njëpushkë..tu mirë vofsh e qofsh! Por kur puna âsht e ngatrrueme dhe s'din njeriu a e ka borxh gjakun a por ia kanë borxh, atëherë âsht hall..*

*Sufa hapi sytëe ngrehi vetullat, i çuditun. Atij puna i dukej fare e qartë: I ish marrë nderi, kishte të drejtë shpagimi. Desht me e thânë këtë, por e mbajt. Donte me dijtë se ku po del puna.*

*Halili thithte cigaren tue ulë e tue shtrëngue vetullat si me dashtë me gjetë fjalët. Kur çeli gojën foli rrallas, tue qitë tym duhanit jashtë bashkë me fjalë”<sup>92</sup>.*

Në novelë kemi dy rrafshe të forta diskursive me prejardhje etnologjike e psikologjike, ku ndërthuren në një diskurs të fuqishëm letrar- simbolik, i cili i afrohet parabolës.

*“Ishte, po, i piklluem thellsisht e i u bânte, bile, si me pasë vû vetë me duert e veta një shkrep në zëmër, por s'ndiente kurrfarë pendimi për vepër të bâme”<sup>93</sup>.*

Këtu më së miri shihet bota psikologjike e personazhit. Mina, vashë e re e Malësisë, vdes, sepse e vret i ati. Ajo nuk vdes si heroine, por vritet nga dora e të atit të vet, sepse ka thyer rregullat e kodit të familjes, kishte zgjedhur një të dashur pa dijeninë e familjes.

Si njohës mjaft i mirë i psikologjisë dhe mjedisit shqiptar, si atij malësor e qytetar, ai nuk ngurron të shprehet për mungesën e kulturës në disa raste. Për Koliqin vetë kultura është shkrirja e intuitës natyrore me dijen që përfitohet nga studimi. Për pasojë ai vlerëson shumë më tepër zgjuarsinë natyrore të malësorëve, sesa kulturën e mangët.

*“Pleqt e të dy palëve u ndeshën në ditë të shënueme në vend ku ish ndá oroku. Pa u ulë ende prej kalit një ndër pleq të njimtarit i solli një pyetje të shkurtë por plot kuptim Xhep Nelit, plakut mâ të suqet të Sufës, që kishte mbërrî para tij e ishte tue e pritun përjashta me gjithë shokë. Si mbas zakonit të malësorëve, donyte me e gërgá pak tue e prekë ndër tela për me hetue, nga përgjegja e tij, para se me hy në themel të çashitjes, se me ç'lloj argumentash*

---

<sup>92</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Se qofsh, pleqnofsh*, f. 72.

<sup>93</sup>Po aty, f. 79.



*mëndonte ta mprojë anën e vet. Pyetja e hollë, që plaku i Hajdar Lilit bâni në atë trajtën e përfytyrueshme në të cilën malësorët tonë janë mjeshtra, qe kjo:*

*Pse ma derdhe atë miell?*

*Xhep Neli, plaku i Sufës, e përfshiu fluturim rëndësin e atyne fjalëve dhe aty për aty ia priti:*

*Çka kërkoi mielli yt në thes tem?*

*Plaku i Hajdar Lilit mbet i topitun e s'dijti çka me iu përgjegjë. Kuptoi menjherë se çâshtja ishte e humbur për të.*

*Prandej, tue njohtë kalorsisht zotësinë e të drejtën e kundërshtarit, solli kalin, u bâni shênj shokëve me e ndjekë edhe la Xhep Nelin fitues mbi vend të pleqësisë me këto fjalë:*

*Se qofsh, pleqnofsh!*<sup>94</sup>.

Vlerësimin për këtë aspekt ai do ta shprehte artistikisht që më shumë në këtë novelë. Është lënë krejtërisht mënjanë tragjedia e shuarjes së dy jetëve për të vënë theksin në gjykimin e urtë të pleqve. Edhe këtu është pikërisht magjia e kanunit që do ta mahnis autorin, dhe kjo magji do përjetësohet në novelë. Tragjeditë personale të njerëzve dhe përshkrimin psikologjik të tyre, Koliqi i jetëson në novelë.

Në novelën “*Se qofsh, pleqnofsh*”, Koliqi derdh tërë fantazinë e tij prej një njohësi të thellë të gjithçkaje që ishte shqiptare, për të na dhënë karaktere tipike të Malësisë së Shkodrës, situata konkrete herë-herë të dhembshme të një mentaliteti arkaik me të cilin karakterizoheshin malësorët shqiptarë. Mina, e bija e Files dhe Sufës, mbetet shtatzënë pa dijeninë dhe pa dëshirën e prindërve dhe për një mëkat të tillë, ajo do ta pësojë në mënyrën më tragjike: vritet nga i ati. Por tragjikja arrin kulmin kur Hajdar Liti kërkon gjakun e fëmijës i cili ishte flijuar ende pa dalë në jetë. Në novelë kemi dy rrafshë të forta diskursive me prejardhje etnologjike e psikologjike, ku ndërthuren në një diskurs të fuqishëm letrar- simbolik, i cili i afrohet parabolës. “*Ishte, po, i piklluem thellsisht e i u bânte, bile, si me pasë vû vetë me duert e veta një shkrep në zëmër, por s'ndiente kurrfarë pendimi për vepër të bâme.*”<sup>95</sup> Këtu më së miri shihet bota psikologjike e personazhit. Mina, vashë e re e Malësisë, vdes, sepse e vret i ati. Ajo nuk vdes si heroinë por vritet nga dora e të atit të vet sepse ka thyer rregullat e kodit të familjes, kishte zgjedhur një të dashur pa dijeninë e familjes.

<sup>94</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Se qofsh, pleqnofsh*, f. 74-75.

<sup>95</sup>Ernest Koliqi, tregimi, *Se qofsh, pleqnofsh*, f. 79.

Si njohës mjaft i mirë i psikologjisë dhe mjedisit shqiptar, si atij malësor e qytetar, ai nuk ngurron të shprehet për mungesën e kulturës në disa raste. Përvetë Koliqin kultura është shkrirja e intuitës natyrore me dijen që përfitohet nga studimi. Për pasojë ai vlerëson shumë më tepër zgjuarsinë natyrore të malësorëve, sesa kulturën e mangët. Vlerësimin për këtë aspekt ai do ta shprehte artistikisht që në shumë në këtë novelë. Është lënë krejtësisht mënjanë tragjedia e shuarjes së dy jetëve për të vënë theksin në gjykimin e urtë të pleqve. Edhe këtu është pikërisht magjia e kanunit që do ta mahnis autorin, dhe kjo magji do përjetësohet në novelë. Tragjeditë personale të njerëzve dhe përshkrimin psikologjik të tyre, Koliqi i jetëson në novelë.

## KREU II: Koliqi përfaqësues i prozës moderne shqipe (Tregtar flamujsh)

### 2.1. Simboli i flamurit si shenjë e identitetit kombëtar shqiptar

Në kohën kur Ernest Koliqi erdhi në letërsinë shqipe, proza ende nuk ishte një zhanër i mirëfilltë letrar me të gjitha karakteristikat e saj. Më shumë kishte përmasa moralizuese, sentimentaliste dhe didaktike. Koliqi duke qenë nxënës i dalë nga tradita e shkollës letrare shkodrane jezuite dhe i kultivuar nëpër qendra universitare, siç ishte ajo Padovës, ishte zhvilluar si individualitet me një mendim të kultivuar letrar.

Duke qenë në kontakt me kulturën evropiane perëndimore, ai merr shumë dhe frymëzohet nga ajo kulturë. Kështu ai bëhet themeluesi i prozës moderne shqipe, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin stilistik, bashkë me Konicën, Kutelin e Migjenin. Duke qenë e tillë, proza e tij, bëhet një aspekt shumë i rëndësishëm në letërsinë shqipe, ajo mbetet novatore e shkëlqyer e fillimeve të modernitetit shqiptar.

Vëllimi me tregime *“Tregtar flamujsh”*, është një nga veprat më të arrira artistikisht në fushën e prozës në gjithë letërsinë shqipe. Në vëllimin *“Tregtar flamujsh”* i cili është botuar në vitin 1935, trajtohet jeta e qytetit të Shkodrës, qytetit ku u lind dhe u rrit Koliqi.

Në vepër shpaloset mentaliteti i vendit, harmonia e jetës, përshkrimi i personazheve që përfaqësojnë shtresa dhe mentalitete të ndryshme shoqërore. Pra, në qendër të kësaj vepre janë temat urbane. Vëllimi *“Tregtar flamujsh”* ka gjashtëmbëdhjetë tregime. Ato janë: *“Tregtar flamujsh”*, *“A ta laçë?”*, *“Anmiku në shtëpi”*, *“Dramë e vogël”*, *“Vena shtatë vjeçe”*, *“E gjeti mbas shimshirit”*, *“Vaji i qitun”*, *“Bilbilat e plepishtit”*, *“Duert e Nânës”*, *“Kumbulla përtej murit”*, *“Rrokoll 12”*, *“Një ngjarje në rrugicën Kezenaj”*, *“Një ditë prej ditësh”*, *“Lumnia”*, *“Hânë gjaku”*, *“Djepi i arit”*.

Karakteristikë themelore e tregimeve të këtij libri është dhe thellimi në botën psikologjike të personazheve, duke përshkruar botën e brendshme dhe të jashtme të tyre.

*“Në novelën Koliqiane “Tregtar flamujsh” duket influenca e Moupasanit dhe Proustit. Nga Moupassani ka marrë metodën natyraliste, jo pjesën fotografike, por mjeshtërinë që të formojë me pak vija fytyra dhe rrethe me stil të natyrshëm, që herë-herë arrin në thjeshtësinë klasike me një vërejtje të mprehtë, e cila arrin thellësinë psikologjike proustiane. Nga Prousti*

*ka mësuar të hyjë thellë në dramën e imët të jetës e të vdekjes, të bëjë analizë të thellë psikologjike, pa përdorur terma të psikologjisë”<sup>96</sup>.*

Në tregimin “*Tregtar flamujsh*” jeta nuk trajtohet në totalitetin e saj, nuk jepet një tablo e plotë me të gjitha përmasat e saj. Këtu bëhet zgjedhja e një dukurie dhe situatë të veçanta e tipike, shumë të ndjeshme për popullin shqiptar. Paraqitet flamuri kombëtar si simbol i identitetit kombëtar në njërin anë dhe flamuri simjet material vetëm për shitje në anën tjetër. (Këtu kemi edhe ballafaqimin mes dy botëkuptimeve njerëzore).

Libri i tregimeve “*Tregtar flamujsh*” është enciklopedi artistike e qytetit të Shkodrës të viteve 1929-1935. Përmbledhja me disa përjashtime, është konceptuar tërësisht në argumentin e botës së tregtarëve, spekulantëve e aventurierëve shkodranë. Qyteti i njohur së shumti si metropol i kulturës e traditës shqiptare, te Koliqi, është i kapluar nga ethet e fitimit dhe të bjerrjes së vlerave tradicionale. Autori jep një parodi të rendjes së Shkodrës drejt qytetimit duke ia theksuar me tepri stonaturat përmes personazheve tregtarë dhe intelektualë të shkolluar jashtë vendit siç ishte Hilush Vilza. Përmes trajtimit të jetës së qytetit të Shkodrës autori shpalos mentalitetin e shoqërisë, një harmoni e jetës autentike e cila merr shqetësime dhe me ambiciet e ndryshme që zbulojnë karakteret deri në lakuriqësi. Flamuri si shenjë kombëtare është njëra nga vlerat më të mëdha që ka populli shqiptar. Shumë nga dijetarët e ndryshëm, autorë, e shumë persona të sferave të ndryshme të jetës kanë vënë hipoteza të ndryshme mbi domethënien dhe vlerën e flamurit kombëtar, por përkundër atyre ai qëndron me hijeshinë e tij, me vlerën e tij të pamohueshme. Për tregtarët siç është Gaspër Tragaçi flamuri nuk përfaqëson ndonjë element që tregon se është shenjë nacionale por një send me të cilin mund ose jo te fitohet. Kurse, për poetin ashtu si poezia, Shqipëria edhe flamuri është i shenjtë. Simbolika e flamurit shihet të jetë një element mjaftë i pranishëm në veprën e Koliqit, madje bëhet edhe faktor kryesor në diskutimet dhe mospajtimet në mes personazheve

---

<sup>96</sup>Vangjel Koça, *Novela dhe novelistët shqiptarë*, “Tomorri i vogël”, 01. 03. 1942.

## 2.2. Roli i Hilush Vilzës dhe Gaspër Tragaçit

Tregimi “*Tregtar flamujsh*” është ai i cili e hap vëllimin me tregime të Koliqit, dhe përmes tij emërtohet tërë ky vëllim. Këtu vë përballë dy personazhe që i afron jeta e qytetit dhe i largojnë idetë. Hilush Vilza, një vjershëtor, kurse Gaspëri është tregtar dhe i njohur i familjes. Mospëlqimi i tyre ndodh jo në jetët e dy brezave, por në botëkuptimin e tyre. I pari fantazon të bukurën, i dyti ngjitet për realen; të dy jeta i shpie nga biseda për Shqipërinë. Tregtari në tregim hyn në ligjërim artistik dhe publicistik si simbol i gjithë asaj kategorie njerëzish që për interesa personale janë gati të shesin gjithçka, qytetin e tyre, atdheun e tyre, gjuhën, flamurin, çdo gjë që mund të blihet. Te tregimi “*Tregtar flamujsh*” Gaspër Tragaçi tregtar parmendash e flamujsh tipizohet me koliritin e filistinëve që tregtonin në tempujt e shenjtë, por Gaspëri ka një veti negative më tepër se ata, kërkon të spekulojë me shitjen e flamujve kombëtarë. Tregtari ngreh teorinë se i lirë është ai që nuk ka nevojë për tjetrin, kurse poeti mendon që se ushqimi shpirtërorë është për të gjithë. Tregtari mendon se poezia nuk është e dobishme nuk ka kuptim, dhe krijimet i quan përralla e ëndërra, kurse poetin dyqanin e tregtarit e quan varr shpirtërorë të tregtarit. Mospajtimi i këtyre dyve asnjëherë nuk zgjidhet, por arrin kulmin, në të vërtetë artikulon dy mentalitete që jetojnë pranë njëri-tjetrit në Shkodrën jo të madhe madje pikërisht për problemet e Shqipërisë. Tregimi “*Tregtar flamujsh*” e ka personifikuar dhe bërë të famshëm Koliqin si shkrimtar. Mesazhi i tregimit është përvetësuar nga disa gjenerata për shkak të subjektit të thjeshtë dhe gjetjes unike artistike. Tregtari i flamujve paraqitet me një elokuencë të stërholluar atdhetare, duke fshehur më së miri qëllimin e tij final: përdorimin e Hilushit, djalit të mikut të vjetër, si një lloj agjenti për rritjen e frymës kombëtare te qytetarët. Kështu do t’i shiteshin flamujt, por nga ana tjetër, pa i ofruar asgjë në këmbim Hilushit. Gaspëri përdor me mjeshtëri moralin e tij si bujar, duke përmendur si shkaraz kujdesin e tij për familjen Vilza gjatë mungesës së Hilushit në Shkodër. Ai i thotë Hilushit: “*s’më ke gja borxh*”, por i kërkon të propagandojë flamujt kudo dhe të shkruaj në gazetë për “*Shqipninë*” si kompensim moral për atë kujdes që pati treguar për shtëpinë e Hilushit. Më në fund të dy personazhet e përbuzin njëri-tjetrin për konceptet e ndryshme që kanë për flamurin, njëri si mall dhe tjetri si ideal, njëri si përfitim, tjetri si tempull virtytetsh kombëtare.

Sipas Ardian Marashit në një studim të bërë për Koliqin shprehet se është rasti të konstatohet se qysh herët në shkrimet e Koliqit vendlindja asimilohet me simbolin frojdist të nënës jetëdhënëse: është plot vitalitet, forcë e urtësi ai që i ruan të forta lidhjet e trashëgimisë me Nënë jetëdhënëse; përkundrazi, kush devijon në planin e trashëgimisë bjerr virtytet bazë të

nderit, burrërisë e humanitetit dhe kthehet në një dobiç pa taban si Gaspër tragaçi i “Tregtar flamujsh”. I njëjti devijim si pasojë e shkëputjes nga Nëna jetëdhënëse, ajo paraqitet si tipi i ish-agjitateores komuniste të edukuar me një kulturë, që është gjithçka tjetër përpos kulturë shkodrane: në dejet e saj nuk lëvrin më lëngu jetëdhënës i rrënjëve të qytetit të moçëm e prandaj ajo mbetet njeri i huaj mes njerëzve të vet më të afërt<sup>97</sup>.

### 2.3. Tiparet e prozës poetike te Koliqi

Proza poetike konsiderohet si formë e ndërmjetme, kalimtare, mes poezisë dhe prozës, e cila ruan karakteristikat zhanrore të të dyjave.

Një nga autorët më seriozë të kësaj periudhe, krahas mjeshtrit të prozës së shkurtër shqiptare, Mitrush Kutelit, që edhe Ernest Koliqi, tregimi i të cilit në letrat shqipe “*u shfaq si refleks origjinal i prozës tregimtare të traditës neolatine*”<sup>98</sup>.

Që në shikim të parë, vërehet se ka pamjen e prozës, fjalitë e shtrira deri në fund të rreshtit dhe rresht pas rreshti, ndërsa që diskursi (gjuha) synon artikulimin në figurë. Vërehet edhe prania e ritmit në fjali, e rimës së brendshme - me shkrirje në formën e asonancave e konsonancave, të cilat i japin muzikalitet të veçantë dhe unik, duke i ngjasuar poezisë; po ashtu, një dinamikë kuptimesh e nuancash poetike të fjalive, e një narracion e fabulë e përhumbar, e ofrojnë me poezinë. Të përbashkët me poezinë ka edhe emocionalitetin e theksuar, shpalimin e përjetimit personal dhe mendimin e ngjeshur, ku imazhi merr vlerë domethënëse, duke u dhënë kuptim edhe elementeve të tjerë shprehës të tekstit.

Origjinalitetin kombëtar të letërsisë Koliqi e sheh sinë formën, ashtu edhe në përmbajtjen e letërsisë, në frymën e saj, në paraqitjen e mjedisit jetësor e tipik të shqiptarit me virtytet e veset e tij, me doket, me mendësinë e gjuhën e vet karakteristike. Origjinaliteti etnik e kombëtar të ligjërimit artistik në gjuhën shqipe në veprën e shkrimtarëve shqiptarë Koliqi e sheh edhe në vendosjen e fjalëve në fjali”, pra në sintaksën e ligjërimit artistik, edhe në kumbimin specifik të vargjeve pra, në bukurtingëllimin krejt të veçantë të tyre në shqip<sup>99</sup>.

Studiuesi Sabri Hamiti shprehet se modeli shkrimor dhe kulturor i këtij autori është i veçantë në letërsinë shqipe. Duke argumentuar këtë konstatim Hamiti saktëson se në krijëmitarinë e tij hetohet këmbëngulja që vlerat e moçme duhet të jenë bazë për çfarëdo rindërtimi të ri krijues, ndërsa nga ana tjetër, shton se shkollimi në Itali dhe kontaktet me krijues emigrantë të

<sup>97</sup>Ardian Marashi, *Pole Koliqiane*, në: “Studime Shqiptare”, nr. 3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995, f. 35.

<sup>98</sup>Aurel Plasari, *Qasje tregimit të Koliqit*, në: “Jeta e re”, nr. 1, 1995, f. 91.

<sup>99</sup>Ernest Koliqi, *Dy shkolla letrare shkodrane*, në: “Shêjzat”, 1970, nr. 4-6, f. 376.

Europës kishin bërë që Koliqi të kërkonte një stil të ri të shkrimit letrar. Hamiti përfundon me thënien se Koliqi kishte arritur të bëjë pajtimin e këtyre dy kërkesave, në dukje, të papajtueshme. Vetë Koliqi, si shkrimtar krijoi një shkrimtari krejt specifike të vetën; mban marrëdhënie të ngushta me folklorin dhe shkruan për shkrimtarë ose dukuri letrare shqiptare<sup>100</sup>.

Në letërsinë shqipe, proza poetike, si formë e mëvetësishme letrare, u shfaq në periudhën e letërsisë moderne, duke filluar me Faik Konicën, Lumo Skendon, Ernest Koliqin, Migjenin e më vonë edhe Martin Camaj. Shfaqja e prozës poetike, lidhet me kalimin e periudhës së romantizmit dhe tejkalimin e poetikës së saj, kur, krahas formave ekzistuese, filloi shkrimi edhe në forma të reja letrare, siç është proza poetike, e cila u shfaq nën ndikimin e lojës së formave e të zhanreve, fillimisht të letërsisë e mëdha evropiane si ajo franceze, angleze, italiane e gjermane. Ndërkaq, Ernest Koliqi me *“Pasqyrat e Narçizit”*, shfaq fuqinë e prozës poetike simboliste, në të cilën teksti jep efektet dhe aluzionet që dalin nga simboli dhe metafora. Duke shfrytëzuar karakterin dhe potencialin që jep simbolizmi dhe simboli, autori arrin të krijojë një botë imagjinare, ku nuk resht natyra pasionante dhe tunduese e subjektit që rrëfen pas enigmave e dyshimeve njerëzore, ftohtësisë e ngrohtësisë së parrokshme të emocionit. Si përfundim mund të themi se Ernest Koliqi, përfaqëson denjësisht formën e prozës poetike në letërsinë shqipe.

---

<sup>100</sup>Persida Asllani, *Koliqi lexues i De Radës*, në: “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë Shqiptare”, 23/2, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2004, f. 449.

## KREU III: Simboli universal i ujit i dhënë te Koliqi sipas trinitetit (Pasqyrat e Narçizit)

### 3.1. Uji-zjarri-dheu

Vepra letrare e Ernest Koliqit “*Pasqyrat e Narçizit*” është e përbërë nga shtatë prozat poetike: “*Ujë e pusit*”, “*Pasqyrë e vjetër shkodrane*”, “*Kroni i Bardhanjorvet*”, “*Prrue në Dukagjin*”, “*Një çuterr në Helveti*”, “*Vala e detit*”, “*Xhami i dritores sime*”.

Ernest Koliqi si shkrimtar dhe si studiues i letërsisë nuk i është shmangur botëkuptimit të vet, që kultura e letërsia shqipe veçantinë dhe autencitetin e vet duhet ta ruajë edhe ta thellojë edhe në shndërrimet që ia sjell si domosdo moderniteti<sup>101</sup>.

Në veprën “*Pasqyrat e Narçizit*” e cila është botuar në vitin 1936, në shtatë variante, ku shpaloset shpirtii Ernest Koliqit, autori na shfaqet qytetari modern në kërkim të atdheut metafizik. Libri u botua fillimisht në kuadër të “*Gazeta Shqipëtare*” të Barit, drejtuar atëkohë nga Nicola Russo Attoma, kurse si botim më vete panë dritën në vitin 1963 në Romë. Përmes shtatë pasqyrave, përmes shtatë prozave poetike paraqitet tabloja unike e botës shpirtërore të poetit, por edhe e popullit, të cilit i takon poeti, popullit shqiptar. “*Në këtë vepër Koliqi ngadalë krijon autobiografinë e shkrimtarit, e cila mbështetet vetëm në shenjat e në pamjet të cilat i mban gjallë kujtesa, apo i zgjon ëndrra, e të cilat thurin strukturën e tij shpirtërore*”<sup>102</sup>. Vepra në fillim pati një fat tragjik të ndarë në dy pjesë. Fati i parë tragjik lidhet me faktin sebotimi i parë nuk pati mundësinë të njihet e të shpërndahet aq sa të ketë një lexim e promovim të vlerës së tij nga lexues të rëndomtë e nga kritika letrare (Ndoshta edhe për shkak të nivelit shumë të lartë artistik të cilit i takon vepra).

Fati i dytë tragjik i veprës qëndron ne faktin se botimi i dytë i saj ndodhi pikërisht atëherë kur autori veç ishte anatemuar në Shqipëri dhe në Kosovë. (Vepra e tij letrare u ndalua edhe pse nuk përmbante asfarë shenje a parashenje politike. U ndalua për shkak të veprimtarisë politike të autorit, përkatësisë fetare dhe gjuhës letrare të përdorur). Vetë emërtimi i veprës lidhet me një mittë vjetër nga historia e letërsisë botërore. Është fjala këtu për mitin antik të Narçisit, djaloshit i cili ishte ibiri i nimfës Liriopë dhe lumit Cefis. Ai kishte një bukuri të madhe, fitoi dashurinë e shumë djemve dhe vajzave, por ai i largonte të gjithë me një

<sup>101</sup>Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, Tiranë, 2009, f. 339.

<sup>102</sup>Sabri Hamiti, *Studime letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2003, f. 453.



përbuzje të paepur, duke përfshirë këtu edhe nimfën e bukur Eko, e dashuruar marrëzisht pas tij. Por ai i refuzonte të gjithë. Për këtë dënohet nga perëndesha e dashurisë, Afrodita. *“Njëra ndër viktimat e Narçisit u kërkon perëndive të bëjnë gjithçka, që edhe ai të provojë ndjenjën që lind kur është e pamundur të zotërosh objektin e dashurisë tënde. Afrodita - ajo që ndëshkon të gjithë ata që flakin tej dashurinë, e kuptoi kërkesën. Narçisi duke kaluar një ditë pranë një burimi të kulluar, u përkul të pinte ujë, por kaloi në ekstazë duke parë fytyrën e vet. Por, askush nuk mund të kënaqet nga dashuria për veten. Sapo i afrohej pasqyrimin të tij, ai zhdukej. Narçisi i dëshpëruar që nuk mund ta marrë tjetrin në krahët e tij, qëndron buzë ujit duke vazhduar përprjekjet. Ai braktis çdo gjë që e rrethon dhe vdes duke lënguar. Me gjithë të keqen që ka bërë, perënditë nuk duan që ai të zhduket mes harresës dhe ia japin emrin e tij njërës prej luleve të para të pranverës, Narcisit të bukur, të verdhë apo të bardhë.”*<sup>103</sup> Lidhja e veprës së Koliqit me mitin nga lashtësia është më tepër simbolike sesa semantike. Koliqi në veprën thekson se ai ka dashuruar këtë përrallë që nga fëmijëria, prandaj edhe frymëzohet nga ajo. *“Dashunova përrallën e Narçizit me të tanë e hovin e gjakut tim prandveror. E gjithkund e gjithëkah kërkoj pasqyra ku me u pasqyrue, Narçiz e quajta veten ndër ditët e rinisë së parë, tue mos parandie asokohe sa trishtim ma vonë do më shkaktonte ky*<sup>104</sup>.

Ernest Koliqi që në hyrje të veprës thekson se: *“Janë këto shtatë pasqyra, shtatë poemtha në prozë”*,<sup>105</sup> duke përcaktuar në këtë mënyrë vetë statusin zhanror të veprës së tij.

Sipas studiueses Rovena Vata: *“Dinamika e jetës shoqërore, sinë planin ekzistencial, individual, ashtu dhe si formë transhedentale historiko-shoqërore e ka nxitur Koliqin shkrimtar ta përfshijë jetën njerëzore gjithanshmërisht, duke përfshirë kodet dhe kanunet si baza juridike të bashkësisë, por dhe pikëpamjet e lashta filozofike për elementet bazë të jetës: uji, dheu, zjarri”*<sup>106</sup>.

Sipas vizionit të Gaston Bachelard katër elementet që e përbëjnë universin janë: zjarri, ajri, toka dhe uji. Mund të themi që edhe fenomeni i Narçisit është bërë përmes ujit, e po ashtu edhe fytyra e poetit në mënyrë të njëjtë duke kërkuar atë që i ngjan.

Me nocionin modern shenjohe mendimi dhe koncepti i një kohe, i cili nuk kushtëzohet historikisht, por bëhet shenjë e dukurive të periudhave të ndryshme stilistike dhe letrarohistorike<sup>107</sup>.

<sup>103</sup>Gerold Dommermuth-Gudrich, *Mitet më të famshme të lashtësisë*, Spektër, Tiranë, 2006, f. 190.

<sup>104</sup>Ernest Koliqi, *Ujë e pusit*, në: “Pasqyrat e Narçizit”, Camaj – Pipa, Shkodër, 2001, f. 9.

<sup>105</sup>Ernest Koliqi, *Pasqyrat e Narçizit*, Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1996, f. 404.

<sup>106</sup>Rovena Vata, *Miti i malit në letërsinë shqipe: Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Migjeni, Martin Camaj*, Naimi, Tiranë, 2013, f. 134.

<sup>107</sup>Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, Tiranë, 2009, f. 8.

Ajo që e bëri ujin të dallohet prej elementëve të tjera sidomos në poezinë shqipe është se përshkruhet si burim i jetës<sup>108</sup>.

I ngjashëm nga disa aspekte dhe i ndryshëm nga disa të tjera, është simboli i ujit, qoftë det apo rrjedhë uji. Edhe këtu gjejmë të shkruara ndryshimin dhe jetëgjatësinë, lëvizjen e vazhdueshme dhe qëndrueshmërinë, ashtu sikurse kemi edhe ndjesinë e vitalitetit, vazhdimësisë dhe të energjisë, po me një ndryshim: ndërsa zjarri është aventuroz, i shpejtë dhe ekzistues, uji është i heshtur, i ngadaltë dhe i qetë.

Në veprën *“Pasqyrat e Narçizit”* e cila është botuar në vitin 1936, në shtatë variante, ku shpaloset shpirtin i Ernest Koliqit, autori na shfaqet qytetari modern në kërkim të atdheut metafizik. Libri u botua fillimisht në kuadër të *“Gazeta Shqipëtare”* të Barit, drejtuar atëkohë nga Nicola Russo Attoma, kurse si botim më vete panë dritën në vitin 1963 në Romë. Përmes shtatë pasqyrave, përmes shtatë prozave poetike paraqitet tabloja unike e botës shpirtërore të poetit, por edhe e popullit, të cilit i takon poeti, popullit shqiptar.

*“Në këtë vepër Koliqi ngadalë krijon autobiografinë e shkrimtarit, e cila mbështetet vetëm në shenjat e në pamjet të cilat i mban gjallë kujtesa, apo i zgjon ëndrra, e të cilat thurin strukturën e tij shpirtërore”*<sup>109</sup>.

Koliqi do të zërë një vend të ndërmjetëm mes traditës dhe modernes, duke mos rënëprece asnjërës prej tyre, por duke shfrytëzuar strukturat e tyre në funksion të poetikës së veprës së tij.

Pasqyrat e Narçizit bëjnë një bërthamë interesante në sferën e përmbyllur të punëve të Ernest Koliqit<sup>110</sup>.

Koliqi shfrytëzoi me mjaftë shkathësi simbolikën e mitit të Narçizit (ruajmë trajtën e autorit), jo në kuptimin e dashurisë në vetëvete, por të dashurisë në artin dhe përjetësimin artistik të botës e të shpirtit arbëror. Rrëfimi artistik bëhet në veten e parë, çka dëshmon se autori (edhe si narrator) merr pjesë aktive në krijimin e konceptit artistik për botën si formë e mundësisë së njësimi me artin. Gjakimi i mitit të Narçizit zbulon trekëndëshin magjik të poetit: miti-arti-përjetësia. Ky këmbim-shndërrim, as është i rastit, as është formal, por ngjet për arsye se poezia bëhet qenësi-hyjneshë, nuse e shpirtit të tij. Pikërishtë ky këmbim i mundëson poetit realizimin e mitit të Narçizit:shndërrimin dhe fitimin e amshimit. Kjo gjë nuk ngjet për hir të vet individit, por për hir të Atdheut, të popullit që i takon, që shpreh shkallën më të lartë të

---

<sup>108</sup>Valbona Berisha, *“Tema e ujit në poezinë e sotme shqipe”*, në *“Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”*, 29/2, UP, Prishtinë, 2010, f. 391.

<sup>109</sup>Sabri Hamiti, *Studime letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2003, f. 453.

<sup>110</sup>Edlira Tonuzi (Macaj), *Pasqyrat e Narçizit, -Simbolika mitike dhe semiotika e tekstit*, Pavarësia, Durrës, 2012, f. 15.

flijimit individual si akt i vetëdijesimit artistik. Pra, këmbimi-shndërrimi bëhet në rrafshin metafizik, ku mundësohet njësimi me frymën dhe zërin kombëtar (zëri individual – ndërgjegjia kolektive).

Nëpërmjet artit Koliqi kërkon hapësira të reja, lirinë n'avuajt e një pasqyre të vjetër, ku unë s'deshta m'u pasqyrue, del me kërkesa më të larta se të parët e tij. Krijuesi don ta shohë fytyrën e vet të re: Unë kam dëshire ma të gjana e ma të nalta. Lumnija që ju shijuet motit më duket e pakrypë. Në këtë breshnuer të marrun drite, unë due me kundrue fytyrën t'ime të re jo fytyrat e jueja të vjetra.

Koliqi përfaqon virtytet që e kanë cilësuar njeriun tonë ndër shekuj. Koliqi deshi ta përjetësojë zërin e thellësisë së shpirtit të vet, të njësohet me artin si grishje e mistershme, të deportojë në shpirtin e fshehtë të sendeve dhe të ndërlidhë realitetin me mitin. Ai nisat nga miti i pasqyrës së ujit, që ngërthen në vete përmasën filozofike dhe mitike. Atë që nuk e gjen në jetë, që është e paarritshme për të, e gjen dhe e arrinë nëpërmjet këngës, hyjneshës shpirtërore.

Koliqi i qaset dhe e shqipton këngën si simbolin, si Narçizin më tipik e të përjetshëm; ajo lind e përtrihet gjithnjë në botën shqiptare dhe në botën e poetit, lind e përtrihet nga biri, edhe kur nuk është koha e saj, edhe kur i jipet ëndrrës së bukur që gënjen.

Shtatë pasqyrat ose shtatë poemthat nuk nënkuptojnë shtatë objekte të veçanta artistike, nuk shprehin as shtatë mënyra shqiptimi as shtatë kohë, por shtatë tablo refleksionesh, shtatë grishje të mistershme të artit, shtatë pjesë të një tabloje... ku shkrihen koha konkrete, objektive, me abstrakten, subjektiven, me kohën mitike. Simbolet, parabolat dhe diagonalet që funksionojnë brenda veprës, as nuk i nënshtrohen kufijve hapsinorë, as kohorë. Miti i pasqyrës së ujit të lumenjve të Atdheut përdoret si simbol i njohjes retrospektive të vetëvetes dhe të qenësisë së botës shqiptare. Me këtë rikthim e rikujtim ekzistencial, me këtë proces të gjakimit të vetidentifikimit, nënkuptohet procesi vijimësisë dhe i ripërtrirjes; në fytyrën e vet ai vëren fytyrën e të parëve; në damarët e gjakut ndien gjakun e të parëve. Në këto proza poetike autori ka ndërlidhur me mjeshtëri madhështinë dhe bukurinë e artit letrar me madhështinë dhe bukurinë e natyrës, ka njësuar simbolikën e pasur e të jashtëzakonshme të tyre, që këtu shprehen si përbërës i qenësishëm estetik. Shtresë të simbolizmit si në *"Pasqyrat e Narçizit"* nuk vërehen në asnjë vepër të Koliqit. Megjithatë, elementet e kësaj rryme letrare me ndikim në kohën kur u shkrua vepra, janë shkruar dhe pasuruar me elemente të mëvetësishme të përceptimit e të shqiptimit artistik, të qartësisë dhe të mundësisë komunikuese të strukturës tekstore poetike, të simbolikës nga tradita dhe nga mitologjia jonë shekullore.

Me vlerat që kanë *“Pasqyrat e Narçizit”* hyjnë në rradhën e kryeveprave të prozës shqiptare. Nësë i lexojmë më kujdes prozat poetike shumë lehtë vërejmë që kemi të bëjmë me një rrafsh simbolik të krijuar pikësëpari nga simboli i Ujit, zjarrit dhe dheut. Gjithmonë këto tri simbole kanë pasur domethënie të ndryshme. Uji si simboli kryesor në këtë vepër del në forma dhe trajta të ndryshme. Ai herë del i lëvizshëm kur paraqitet kroni, prroi, deti dhe herë del i amullt, i paqartë, kur paraqitet pusi.

*“U përkula me pi në curril të kronit dhe më doli vetja e pasqyrueme n’ujë të lugut. Me at gazhup në shta, dukeshem një njeri tjetër, i panjoftyn. Larg ishin pasqyratme suaza t’arta të shtëpis s’eme në qytet. Por ishem unë e jo tjetër kush. Syt veçse ndritshin tue qitun do shkëndija të mystershme. Sigurisht në fytyrën t’ime aty përtriheshin typaret e ndoj stërgjyshi bari”*<sup>111</sup>.

Kështu shprehet Narratori i cili është vetë Koliqi, pasi libri ka elemente autobiografike, duke personifikuar veten e tij me ujt e currilit.

*“Qyshë në fëmijni dashunova ujnat si të rrjedhëshëm ashtu edhe t’amullt. Valët pasqyruese, sipërfaqet kristalore shum tërhjekse për Narçizin andërrt”*<sup>112</sup>.

Përmes kësaj fjalie e cila në kuptim të parë mund të duket edhe si një lloj deklaratë, Koliqi shpalos të vertetën për dashurinë që ka pasur ndaj ujit në fëmijëri, ndaj këtij simboli universal. Fëmijëria për të është njëperiudhë reflektimi, përmes së cilës formohet edhe karakteri i tij i pastër si uji, karakter që nuk e ndryshon gjithë jetën.

Zjarri përmban elementin e të papriturës, uji elementin e parashikimit. Edhe uji simbolizon një gjendje vitale, po një gjendje më *“tërëndë”*, më *“tëngadaltë”*, më të qetë sesa ekzistuese<sup>113</sup>.

Uji kryen një rol simbolik në fe, sipas Eliade ku simbolizon lindjen dhe përmbytjen e madhe<sup>114</sup>.

Në rastin e simbolit universal gjejmë të njëjtën marrëdhënie midis përvojës mendore dhe përvojës fizike. Simboli universal është i vetmi simbol, tek i cili lidhja midis simbolit dhe asaj që simbolizohet nuk është e rastit, por e brendshme.

Kjo lidhje i ka rrënjët te aftësitë e organizmit tonë, te shqisat tona dhe te mendja jonë, që janë të përbashkëta për të gjithë njerëzit dhe nuk kufizohen te individë të caktuar e të grupe të

<sup>111</sup>Ernest Koliqi, *Pasqyrat e Narçizit*, Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1996, f. 380.

<sup>112</sup>Ernest Koliqi, *Pasqyrat e Narçizit*, Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1996, f. 355.

<sup>113</sup>Erich Fromm, *“Gjuha e harruar”*, Dituria, Tiranë 2007, f. 13.

<sup>114</sup>Mircea Eliade, *“The Sacred and the Profane: The Nature of religion”*, NewYork1961, f. 14.

caktuara. Në të vërtetë, gjuha e simbolit universal është gjuha e përbashkët që ka krijuar gjinia njerëzore dhe që u harrua përpara se të arrinte të përpunonte një gjuhë konvencionale të përbashkët.

Sipas konceptit të filozofik triniteti qëndronte të elementë si: uji, zjarri, dheu, kurse sipas Koliqit - tregimtar triniteti qëndronte respektivisht të këta elemente si: *mali, rranjë, uji*.

Sipas filozofëve lënda që ndodhet në thelb të gjithçkaje dhe që transformohet nga njëri send tek tjetri, është *uji*. Një tjetër thoshte: është *ajri*. Një i tretë: është *zjarri*. Një i katërt: është *pafundësia*.

Por asnjëri prej tyre nuk tha: është toka. Kur filozofët e Miletit thanë: është uji, ajri, zjarri apo vetë pafundësia, nuk është që me këto emra të kenë shënuar “*elementet*”, në kuptimin material të fjalës.<sup>115</sup>

Fshehtësia dhe mistika e *ujit* asnjëherë nuk është e sqaruar deri në fund. *Uji* është i lidhur drejtpërdrejt me proceset më organike dhe veprimtarinë jetësore, ndaj njeriu e ka ndjerë shpesh mungesën e tij kur s’e ka pasur, ashtu sikundër i ka kënduar, kur e ka gjetur dhe e ka rrethuar me gurë, a thua për t’a pronësuar apo për t’a mbrojtur nga syri i keq.

Pasqyrat, si krijime të këtij lloji, kanë tipare të të dy formave. Nëse poezia është arti personal dhe më universal, ku dhe poeti origjinal duket në rini dhe jo në pleqëri, pasqyrat sigurisht që afrohen kësaj me poezinë dhe janë ndërtuar nëpërmjet ndjeshmërisë personale.

Tek “*Pasqyrat e Narçizit*” është përjetimi në të ri, po aq dhe ëndërrimi që lidhet me rininë, apo fëmijërinë, por jo vetëm kjo. Përjetim-ëndërrimi është dualiteti që e afron rrëfimin e Koliqit me poezinë, e cila përkon me rrëfimin në vetë të parë, me monologun dhe karakteristika të tij, forma më e preferuar e shprehjes së të cilit mbetet thelbësisht veta e parë njëjës si vetë e poezisë<sup>116</sup>.

Herakliti mbron idenë se të kundërtat janë kushti i të gjithë sendeve. Këtë ai e shpreh me anë fjalësh të figurshme, mitike: “*Përplasja është babai i të gjitha sendeve*”.

Vetë ndryshimi është një lëvizje e përhershme që i bën sendet t’i nënshtrohen atij. Herakliti nënvizon me forcë përvojën e ndryshimit. “*Gjithçka rrjedh..*” “*Nuk mund të lahesh dy herë*

---

<sup>115</sup>Zhanë Hersh, “*Habia filozofike*”, Dituria, Tiranë 1995, f. 11.

<sup>116</sup>Sabri Hamiti, *Poetika shqipe*, Tiranë, 2010, f. 24-25.

*në të njëjtin lumë*". Kur kthehesh te lumi për herë të dytë, *uji* i mëparshëm tanimë ndodhet larg; është një lumë tjetër, një *ujë* tjetër<sup>117</sup>.

Një nga elementet, që sundon përveç ujit, është zjarri. Edhe në këtë rast, jo zjarri krejt material dhe si një fenomen shpërbërjeje, por një zjarr që është njëkohësisht logosi. Logos është një fjalë greke që do të thotë "*arsye*", "*logjikë*", "*gjuhë*", "*ligj*"<sup>118</sup>.

Zjarri përfaqëson fuqinë e të menduarit në mënyrë racionale, me ndihmesën e së cilës kuptojmë botën ndijore - ajo që sot quhet shkencë e natyrës. Sigurisht Platoni nuk e përdor këtë fjalë; por nënkuptohet që bëhet fjalë tamam për të kapur rregullsinë midis fenomeneve, pra për të zbatuar ligje. Shkenca na lejon të parashikojmë, dhe me këtë veti të na orientojë në gjirin e botës ndijore<sup>119</sup>.

Pra po të vërejmë me vëmendje a nuk e krijon botën poetike Koliqi përmes tokës së tij amë. Toka (pasuria natyrore) dhe të parët e tij (pasuria njerëzore, trashëgimia) janë objekti i dashurisë së tij, e cila merr ngjyresë pozitive, sepse objekti i tij del përtej vetes. Dashuria e tij nuk ka objekt vetveten si Narçizi grek, por i ka rrënjët tek rrënjët e të parëve...<sup>120</sup>.

*Sigurisht në fytyrën t'ime aty përtriheshin typaret e ndoj stërgjyshi bar* (Kroni i Bardhanjorvet) ose...*Kur syni im këthei m'u kundruë në pasqyrë t'ujit të huej, unë s'e njofta më veten time: njimijë fytyra përmblihdeshin në fytyrë t'ime. Ishin ato të të parvet në të cilat gjatë mija vjetësh shkëlqei gjaku shqiptar* (Nji çuterr në Helveti).

Pasqyra te Koliqi na del si një motiv i përsëritshëm, ku pasqyra pasqyron motivin e dashurisë, atë të bukurisë, ndjesive dhe pasigurive.

*Bukurija e zbet e jetës shkodrane të dikurshme mbet e robnueme n'aviujt e nji pasqyre të vjetër, ku unës;deshta me u pasqyrue* (Pasqyrë e vjetër shkodrane).

Pasqyrat e Narçizit, në pjesën më të madhe të tyre, natyra luan rol kryesor. Përshkrimi në veçanti i pjesëve përbërëse të saj si mal, pyll, ujë (përrua, det, ujë i rrjedhshëm apo i qëndrueshëm), ndihmojnë për të kuptuar gërshetimin e mitit me letërsinë artistike.

---

<sup>117</sup>Po aty, f. 15-16.

<sup>118</sup>Sabri Hamiti, *Poetika shqipe*, Tiranë, 2010, f. 16.

<sup>119</sup>Po aty, f. 17.

<sup>120</sup>Edlira Tonuzi (Macaj), *Pasqyrat e Narcizit-Simbolika mitike dhe semiotika e tekstit*, Pavarësia, Durrës, 2012, f. 37.

*Ujë e pusit: Erëza gjithësh e bimësh gufuese, mbi të cilat zotnonte fryma nxitëse e lulemustakut, rrijshin si pezull në paluejtësi t'ajris.*

*Kroni i Bardhonjorvet: ...gjethnaja e lisavet nuk lëvitte asnjë grimë. Shkulma erëzash të breshhta endeshin të lehtë n'ajr t'praruem..*

*Prrue në Dukagjin: ...rrezet e para të ditës, shigjeta xhixhilluese, shkrepsin nëpër blerim të dendun të spërvjerrave bimorë...etj.*

Tek Koliqi jo më kot janë bërë pasqyrimet në grykën e pusit, në pellgje uji, lug, prrue, çezme. Aty ku sigurohet pasqyrimi, aty gjendet edhe simboli. Uji heq fajësinë, konsiderohet si origjinë e jetës, lidhet me rigjenerimin, shërben si mjet i pastrimit, ka në vetvete sakrën (të shenjtën). Uji si simbol i jetës, bëhet edhe simbol i shpirtit.

Uji, në pjesën më të madhe të tij, e ndihmon poetin të gjejë veten, *nëpër rrethana të ndryshme të jetës, të shpirtit*<sup>121</sup>.

“Pasqyrat e Narçizit” nisin si rrëfime personale. Janë shtatë situata që tregojnë shtatë pasqyrime të një “heroi” me emrin Narçiz. Emri i tij lidhet me heroin e mitologjisë greke, me të cilin ai ngjason në fazën fillestare.

“Të krijuara nën frymën e simbolizimit, simbolizmi bëhet një ndër prirjet kryesore stilistike që e mbulon poetikisht tekstin narrativ të Koliqit”<sup>122</sup>.

Tështatë prozat nuk analizohen pa parë që në fillim edhe poetikën e ujit, simbolikën e tij dhe të elementëve të tjerë. Uji rrethon, mbyt dhe nxjerr po në sipërfaqen e tij të fshehtat dhe të pathënat. Ai është elementi vital natyror. Ngarkesë simbolike kanë edhe gjetjet si mali pra toka, natyra, zjarri etj.

---

<sup>121</sup>Ernest Koliqi, *Shënim pas botimit Pasqyra e Narçizit*, në: “Vepra 2”, Prishtinë, 2003, f. 361.

<sup>122</sup>Sali Bashota, *Proza e fillimeve të modernitetit: Konica, Koliqi, Kuteli, Migjeni*, Prishtinë, 2006, f. 71.

## PËRFUNDIME:

Ernest Koliqi bën pjesë në radhën e personaliteteve më të rëndësishme të kulturës dhe historisë shqiptare. Përmes veprave që kemi marrë në analizë si *“Hija e maleve”*, *“Tregtar flamujsh”* dhe *“Pasqyrat e Narçizit”*, mund të themi se Ernest Koliqi është një njohës i mirë i psikologjisë njerëzore dhe etnografisë shqiptare. Gjithashtu ai është një njohës më se i mirë i traditave dhe zakoneve shqiptare. Ai hyn thellë në psikologjinë e personazheve të tij, bënë përshkrimin e ndjenjave të tyre, pamjes së jashtme dhe shpirtërore. Ernest Koliqi me gjithë trashëgiminë e tij krijuese, zë një vend të rëndësishëm në historinë e letërsisë dhe të kulturës shqiptare. Ai bëhet faktor kyq në zhvillimin e prozës moderne shqipe. Me veprat letrare *“Hija e maleve”* dhe *“Tregtar flamujsh”* ai shënon një hap shumë të rëndësishëm në prozën moderne shqipe. Në vëllimin me tregime dhe novela *“Hija e maleve”*, autori përzgjedh tema që kanë gjenezën në moralin e malësisë dhe të malësorit, duke i shtjelluar tutje ato me gjithë dramacitetin dhe tragjicitetin e tyre edhe në mesin urban. Vëllimi me tregime *“Tregtar flamujsh”*, autori përzgjedh tema dhe motive nga jeta urbane e qytetit të tij të lindjes, duke zbuluar përmes tyre ambiciet e njerëzve urban dhe dallimet që ekzistonin midis shtresave të shoqërisë. Gjithashtu Koliqi ka meritat e veta edhe për zhvillimin e mëtejshëm dhe afirmimin e prozës poetike, një zhanër ky letrar mes prozës dhe poezisë. Me veprën *“Pasqyrat e Narçizit”* Koliqi, e bën prozën poetike një fenomen artistik në letrat shqipe. Këtë gjë e arrin përmes shtatë prozave poetike, ku përmes gërshëtimit të mitit antik dhe elementeve autobiografike, Koliqi spikat veprën e tij letrare. Te *“Pasqyrat e Narçizit”*, vetë shpalosja e indentitetit shpirtëror personal në shtatë trajta është fakt i mjaftueshëm për të konstatuar se gjithë novela e përbërë nga shtatë tregime ka një temë të vetme, që shquhet për kohezion dhe koherencë tekstore, nga fillimi deri në fund. Konteksti del i ndërtuar me një shkallë të lartë homogjeniteti. Kalimi nga një tregim në tjetrin përmes fjalëve referenciale dhe kalimtare është i lehtë dhe mbase i pahetueshëm nga marrësi<sup>123</sup>. Duke qenë një ithtar kaq i madh i elementeve popullore dhe mitologjisë shqiptare, ai s’ka si t’i lë anash edhe tri elementet më të rëndësishme të këtyre besimeve. Janë uji, zjarri dhe dheu që pasurojnë artistikisht veprën e tij dhe që pasqyrojnë një trini të pazëvendësueshme. Si perfundim mund të themi se: ajo çka na rrëfen Koliqi është jashtëzakonisht e veçantë, diçka e re e parë më parë në letërsinë shqipe.

---

<sup>123</sup>Haki Hysenaj, *Teskta dhe konteksti në gjuhën e veprës së Ernest Koliqit*, në: “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë Shqiptare”, nr. 27/1, Universiteti i Prishtinës, f. 85.



## BIBLIOGRAFIA:

- Asllani, Persida.** *Koliqi lexues i De Radës*, në: “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë Shqiptare”, 23/2, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2004.
- Bashota, Sali.** *Domethënia e ideve letrare*, Rilindja, Prishtinë, 2001.
- Bashota, Sali.** *Proza e fillimeve të modernitetit: Konica, Koliqi, Kuteli, Migjeni*, Prishtinë, 2006.
- Berisha, Anton.** *Ernest Koliqi, poet dhe prozator*, Toena, Tiranë, 1997.
- Berisha, Valbona.** “Tema e ujit në poezinë e sotme shqipe”, në “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, 29/2, UP, Prishtinë, 2010.
- Chevrel, Yves.** *Letërsia e krahësuar*, Tiranë, 2002.
- Dervishi, Zyhdi.** *Vështrime të kryqëzuara në det*, Jerusalem, Tiranë, 2003.
- Eco, Umberto.** *Si shkruaj*, AIDK, Prishtinë, 2003.
- Eliade, Mircea.** *The Sacred and the Profane: The Nature of religion*, New York, 1961.
- Fromm, Erich.** *Gjuha e harruar*, Dituria, Tiranë, 2007.
- Gerold Dommermuth-Gudrich.** *Mitet më të famshme të lashtësisë*, Spektër, Tiranë, 2006.
- Hamiti, Sabri.** *Gjaku e Bajraku*, në: “Jeta e re”, nr. 1, Prishtinë, 1995.
- Hamiti, Sabri.** *Letërsia moderne shqipe*, Tiranë, 2009.
- Hamiti, Sabri.** *Poetika shqipe*, Tiranë, 2010.
- Hamiti, Sabri.** *Studime letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2003.
- Hersh, Zhanë.** *“Habia filozofike”*, Dituria, Tiranë, 1995.
- Hilushi.** *Letra të hapuna një të riu letrar*, në: revistën “Shêjzat”, 1970, nr. 4-6, f. 99.
- Hysenaj, Haki.** *Teskti dhe konteksti në gjuhën e veprës së Ernest Koliqit*, në: “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën dhe Letërsinë Shqiptare”, nr. 27/1, Universiteti i Prishtinës.
- Jakllari, Adem.** *Histori e mendimit etnologjik dhe mitologjik*, Tiranë, 2003.
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, Neni 602.
- Koça, Vangjel.** *Novela dhe novelistët shqiptarë*, “Tomorri i vogël”, 01. 03. 1942.
- Koliqi, Ernest.** *Dy shkolla letrare shkodrane*, në: “Shêjzat”, 1970, nr. 4-6.
- Koliqi, Ernest.** *novela Gjaku*, në: “Hija e maleve”, Buzuku, Prishtinë, 2003.
- Koliqi, Ernest.** *Pasqyrat e Narcizit*, Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1996.
- Koliqi, Ernest.** *Shënim pas botimit Pasqyra e Narcizit*, në: “Vepra 2”, Prishtinë, 2003.
- Koliqi, Ernest.** *Shkodër, 20 maj 1903 - Romë, 15 janar 1975*.
- Koliqi, Ernest.** *Ujët e pusit*, në: “Pasqyrat e Narcizit”, Camaj – Pipa, Shkodër, 2001.

- Krasniqi, Milazim.** *Idealizimi konceptual dhe praktika modeste e Koliqit*, në: “Soneti në poezinë shqipe”, Prishtinë, 2005.
- Krasniqi, Nysret.** *Episteme letrare*, AIKD, Tiranë, 2010.
- Marashi, Ardian.** *Pole Koliqiane*, në: “Studime Shqiptare”, nr. 3, Ernest Koliqi 1903-1975, Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Letërsisë, Shkodër, 1995.
- Muhadri, Besim.** *Proza e Ernest Koliqit në kontekstin e letërsisë shqipe të shekullit XX*, në: “Albanologjia”, Vol. 4, Tetovë, Maqedoni, 2017.
- Muhametaj, Enver.** *Ndihmesa të Ernest Koliqit në mendimin teoriko-letrar shqiptar*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2008..
- Plasari, Aurel.** *Qasje tregimit të Koliqit*, në: “Jeta e re”, nr. 1, 1995.  
Revista: “Shêjzat”, nr. Perkujtimuer kushtue Ernest Koliqit, f. 169.
- Rrahamani, Kujtim.** *Intertekstualiteti dhe oraliteti, E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku*, AIKD, Prishtinë, 2002.
- Shehri, Dhurata.** *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, Tiranë, 2006.
- Shehri, Dhurata.** *Përralla si tregim brenda tregimit*, në: Akte të Konferencës shkencore “Letërsia si e tillë, Toena, Tiranë, 1996.
- Shestani, Matish.** *Ernest Koliqi në mendimin e bashkëkohësve dhe studjuesve*, Pegi, Tiranë, 2000.
- Smaqi, Laura.** *Funksioni poetik i zanës në tregimet e Ernest Koliqit*, në: “Studime filologjike”, nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2000.
- Smaqi, Laura.** *Zbulimi i vetvetes n’pasqyrë t’letravet*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Departamenti i Studimeve Letrare, Tiranë, 2009.
- Tirta, Mark.** *Mitologjia ndër shqiptare*, Mësonjëtorja, Tiranë, 2004.
- Tonuzi (Macaj), Edlira.** *Pasqyrat e Narçizit, -Simbolika mitike dhe semiotika e tekstit*, Pavarësia, Durrës, 2012.
- Vata, Rovena.** *Miti i malit në letërsinë shqipe: Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Migjeni, Martin Camaj, Naimi*, Tiranë, 2013.
- Vata, Rovena.** *Paradigma e mitit të malit dhe fantastika te Koliqi*, në: “Alternativa”, revistë për kulturë dhe shkencë, Lublanë, 2013.
- Williams, Robin M.** *American Society: Asociological interpretation*, Third Edition, Knopf, New York, 1970.
- Williams, Xhorxh Fred.** *Shqiptarët*, Shtëpia Botuese, Argeta – LMG, Tiranë, 1999.

**Xhiku, Ali.** *Letërsia shqipe si polifoni*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Letërsisë dhe i Gjuhësisë, Dituria, Tiranë, 2004.

**Zhenet, Zherar.** *Figurat*, Rilindja, Prishtinë, 1985.